



Projekti: Pjesëmarrje më e madhe, politika dhe rregullativë më e mirë

Testimi ekstern, notimi, sfidat, dhe hapat e ardhshëm: Testim ekstern me çdo kusht?



Projekti: Pjesëmarrje më e madhe,
politika dhe rregullativë më e mirë

Testimi ekstern, notimi, sfidat, dhe hapat e ardhshëm: Testim ekstern me çdo kusht?



| *Citizens for change!*

Civica Mobilitas is a Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) project that is implemented by NIRAS, MCIC and SIPU. Opinions expressed herein do not necessarily reflect the viewpoints of the Civica Mobilitas, SDC or implementing organizations.

PUBLIKIMI

TESTIMI EKSTERN, SFIDAT DHE HAPAT E ARDHSHËM:
TESTIM EKSTERN ME ÇDO KUSHT?

BOTUES

Instituti dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (CUP),
në partneritet me ZIP Institute

PËR BOTUESIN

Neda Maleska Saçmaroska
Agim Selami

PËRGATITUR NGA NJË GRUP AUTORËSH

Petar Kamçev, Veli Kreci, Neda Maleska Saçmaroska
dhe Agim Selami

PËRKTHIMI SHQIP

Miranda Rameti

LEKTOROI

Miranda Rameti

DIZAJN

Muhsin Gyler

PRINTIMI

TOPPRINT - Qendër Digjitale për Print

TIRAZHI

200 kopje

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37.091.27(497.7)"2005/2015"(047.31)

TESTIMI ekstern, notimi, sfidat dhe hapat e ardhshëm : testim
ekstern me çdo kusht?. - Shkup : Qendra për administrim me ndryshime,
2016. - 43 str. : граф. прикази ; 30 см

Публикацијата е во рамките на проектот: "Пјесемаррје më e мадхе,
политика дхе ррегулативë më e мирë". - Фусноти кон текстот. -
Библиографија: стр. 34

ISBN 978-608-4818-05-2

а) Екстерно тестирање - Македонија - 2005-2015 - Истражувања
COBISS.MK-ID 101854218

PËRMBAJTJA

6	<u>Rezime dhe diskutim përmbyllës</u>
8	<u>I. Hyrje</u>
9	<u>II. Korniza teorike</u>
12	<u>III. Përvoja e Magedonisë me testimin ekstern</u>
13	<u>1. Përshkrim i shkurtër mbi vlerësimin ekstern në Magedoni</u>
15	<u>2. Kushtetuta dhe testimi ekstern</u>
16	<u>3. Përvojat nga vendet tjera</u>
18	<u>IV. Metodologjia e hulumtimit</u>
18	<u>1. Pyetësi gjysëm-strukturor - verzioni i profesorëve dhe nxënësve</u>
19	<u>2. Analiza e të dhënave sekondare</u>
20	<u>3. Diskutim me palët e interesuara</u>
20	<u>V. Analiza e rezultateve të studimit – Konstatimet nga hulumtimi dhe anketa e zbatuar tek nxënësit dhe mësimitdhënësit</u>
33	<u>VI. Përfundimet e përgjithshme përmbledhëse dhe rekomandimet e hulumtimit bazë të nevojave të testimit ekstern</u>
37	<u>VII. Bibliografija</u>
38	<u>ANEKSI 1 MËSIMDHËNËS</u>
42	<u>ANEKSI 2 NXËNËS</u>

REZIME DHE DISKUTIM PËRMBYLLËS

Vënia në funksion e testimit ekstern për matjen e njohurive të nxënësve është një ndër reformat më të diskutueshme në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë për shkak të publicitetit të gjerë dhe ngjarjet në diskursin publik. Zbatimi i këtij ligji është përballuar me sfida serioze, mirëpo matja e efektit pas funksionimit të ligjit, 5 vjet pas funksionimi, mungon dhe nuk arrinë të japë pasqyrë të qartë nëse koncepti i testimit ekstern kontribuon në qëllimin e caktuar: përcaktimi i objektivitetit në notim tek mësuesit dhe vetë-reflektimi i njohurive të arritura tek nxënësit.

Hulumtimi, para jush, përpiqet të bëjë të ditur perceptimin e të vlerësuarve (mësuesit dhe profesorët) për përmbushjen e këtij qëllimi të caktuar. Duke matur perceptimin e atyre që janë të prekur drejtpërdrejtë nga kjo politikë duhet të shfaqet fotografia për lidhjen ndërmjet qëllimit të testimit ekstern, e vendosur nga ana e hartuesve të politikave, dhe përdoruesve final: mësimeve dhe nxënësve. A është përmirësuar objektiviteti në notim nga ana e mësuesve? Cili është ndikimi i testimit ekstern tek nxënësit? A ndikon testimi ekstern në përmirësimin e cilësisë së arsimit? Të gjitha këto janë pyetje që ende krijojnë mosmarrëveshje serioze publike mes aktorëve kryesorë në arsim.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë, nxënës dhe mësues (80% -85% e të anketuarve), janë të pakënaqur me zbatimin e testimit ekstern, në fakt janë të mendimit se nuk duhet të vazhdohet me konceptin e testimit ekstern (76% e mësuesve dhe 84% e nxënësve).

Lidhja e fortë mes mirënjohjes dhe dënimit të mësimeve për rezultatet e arritura nga testimi ekstern ka ndikim të mundshëm në sjelljen e mësuesve, gjegjësisht inkurajon mësuesit që ligjëratat e tyre ti përshtasin me pyetjet e testit ekstern ose të gjithë materialin ta përqëndrojnë në atë që do të parashtrohet në testimin ekstern (teaching to the test). Përveç kësaj, sipas rezultateve të hulumtimit, gati 40% e të anketuarve në mesin e studentëve janë të mendimit se mësuesit nuk e kanë të definuar notën përfundimtare para se të realizohet testimi ekstern, gjë e cila krijon hapësirë për «përshtatjen» e mëtejshme të notave varësisht nga rezultati i arritur në testimin ekstern që rezulton në shmangien e lëshimeve më të mëdha.

Rezultatet e testimit ekstern fillimisht u adresohen mësuesve, respektivisht shërbejnë për miërnjohjen dhe/ose dënimin e mësuesve. Gjegjësisht, në bazë të kornizës ligjore që e rregullon arsimin e mesëm, duke u bazuar në rezultatet e testimit ekstern, me testimin e njohurive të nxënësve përcaktohet progresi i karrierës së mësimeve dhe stafit të bashkëpunëtorëve nëpër shkolla, si dhe shuma e pagës së tyre (zbatimi i këtyre dispozitave është shtyrë disa herë).

Përdorimi, ekskluzivisht, i rezultateve të testimit ekstern të nxënësve nuk është i mjaftueshëm dhe i plotë për të arritur qëllimin e dëshiruar – notim objektiv dhe real. Gjegjësisht, në bazë të rezultateve të hulumtimit, ¾ e të anketuarve në mesin e nxënësve respektivisht diku deri 80% e mësuesve mendojnë se vlerësimi i testimit ekstern nuk ka efekt në objektivitetin në vlerësimin e mësuesit.

Sipas rezultateve, 71% e të anketuarve të cilët ishin mësimeve dhe 56% e të anketuarve nxënës janë të mendimit se nxënësit kopjojnë gjatë zbatimit të testimit ekstern, ndërsa gati gjysma e të anketuarve mendojnë se mësuesit u ndihmojnë apo u tregojnë nxënësve gjatë zbatimit të testimit ekstern (40% nxënës dhe 47% mësues).

Rezultatet e këtij lloji tregojnë se një nga efektet më të dukshme të zbatimit të kësaj mase është krijimi i bazës «mediokre» në vlerësimin apo notimin nga ana e mësuesit, ose më sakt e thënë efekti i notave mesatare. Në fakt, shumica e mësimeve i qasen noti-

mit mesatar me qëllim që të shamangin mospërputhjet e mëdha të cilat mund të çojnë në dënimin e mundshëm dhe reduktimin e të ardhurave mujore ose miërnjohje/avancim nëse dallimet e vogla janë të vazhdueshme. Me këtë në mënyrë direkte i shkaktohet dëm procesit arsimor dhe nxënësve, si dhe vjen deri tek prishja e kredibilitetit dhe autoritetit që u është dhënë mësimdhënësve në mesin e nxënësve të tyre.

Vlerësimi apo notimi i standardizuar, në anën tjetër është një metodë e përdorur gjerësisht për testimin e njohurive dhe aftësive të nxënësve dhe mund të jetë një tregues i mirë i nivelit të cilësisë së arsimit, sëbashku me masat dhe reformat e ngjajshme në arsim. Centralizimi (njëanshmëria) e kriteriumeve për notim paraqesin bazë për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit në Republikën e Maqedonisë, pra heqja e testimit ekstern duket si masë radikale, por një rishikim i gjerë, zgjerimi dhe përmirësimi i listës së objektivave dhe masave sigurisht që do të kontribuojë në ecjen drejt një procesi arsimor të mirë dhe të standardizuar. Prandaj, është i patjetërsueshëm një rishikim dhe zgjerim i plotë i qëllimit të testimit ekstern apo përdorimi e këtij mjeti me qëllim që të përmirësohet procesi arsimor dhe të kontribuon në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Është e patjetërsueshme të hiqen të gjitha dispozitat e ligjit në lidhje me rregullimin e dënimin të mësuesve dhe ndërhyrjes adekuate legjislativë në pjesën që rregullon mundësinë e të venduarit notën 1(njish) në dëftesën e nxënësve si notë e arritur në testimin ekstern. Një dispozitë e tillë është në kundërshtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm dhe dëmton procesin arsimor dhe vetë nxënësit në fazat e tyre në arsimin e mëtejshëm dhe duhet të shfuqizohet.

Auditimi duhet ti referohet edhe konceptit të testimit. Testi nga 30 pyetje me përgjigje të shumta dhe pyetje të dhëna tri ditë më parë mund të mos jetë i përshtatshëm për vlerësimin e njohurive të arritura dhe aftësitë e nxënësve që janë fituar me ndihmën e mësimdhënësve gjatë gjithë vitit, as nuk është reflektim i njohurive të tyre të vërteta. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të bëhet analizë e procesit aktual të testimit ekstern apo zbatimi, rezultatet, etj «efektet anësore» të testimit ekstern me përfshirjen e plotë të ekspertëve publik me qëllim që të shqyrtohet politika dhe të bëhen ndërhyrjet përkatëse në legjislacion.

Së fundi dhe më e rëndësishmja, testimi ekstern duhet të jetë më i relaksuar apo i qetë, në mënyrë të rastësishme dhe vullnetare për të matur njohuritë e nxënësve dhe objektivitetin e mësimdhënësve e studentëve pa asnjë penalizim apo dënim për cilin do nga nxënësit që është pjesë e këtij procesi dhe duhet të shërbejë si vërejtje për vetë mësuesit dhe stafin udhëheqës se ku dhe si duhet ta përmirësojnë përvetësimin e njohurive nga ana e nxënësve. Rezultatet duhet të bëhen publike në kontekstin e konkurrencës së shëndoshë ndërmjet shkollave.



I. HYRJJE

Arsim cilësor dhe kapitali njerëzor paraqesin një kusht thelbësor për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Prandaj, në Republikën e Maqedonisë, në të gjitha këto vite që nga pavarësia e saj e deri më sot, reformat në sektorin e arsimit janë vazhdimisht aktuale apo bëhet përpjekje dhe investohet vazhdimisht me qëllim që të përmirësohet cilësia e arsimit si dhe niveli e njohurive dhe aftësive tek nxënësit.

Ndër reformat e shumta të realizuara në vitet e fundit, të tilla si «Përmirësimi i aftësive të mësuesve për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie», programet mësimore sipas Kembrixh, «Prind i informuar (Ditari elektorinik)», «Matura Shtetërore», këtu bashkangjitet edhe «Kontrollimi i jashtëm i suksesit të arritur të nxënësve», zakonisht i njohur si «Testimi ekstern apo notimi ekstern». Përshtypja e përgjithshme është se ofrimi i projekteve të reformave është i rregullt dhe i vazhdueshëm, mirëpo ende ka nevojë për të ruajtur vazhdimësinë e proceseve të cilat kanë filluar, si dhe përmirësimin e konsistencës dhe koherencën midis reformave të ndryshme në arsim.

Nevoja për të futur testimin ekstern në arsimin fillor dhe të mesëm është vërtetuar dhe dokumentuar në Programin nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015, ku, ndër të tjera, si arsye përmenden subjektivizmi në vlerësimin e mësuesve, si dhe tendenca e rritjes (gjithnjë e më e theksuar) në përqindjen e nxënësve të shkëlqyer në vitet e fundit¹. Si një arsye shtesë thekson rezultatin e dobët të nxënësve maqedonas testimit PISA (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve) të vitit 2000, Maqedonia u rendit në mesin e më e dobët e testit nga fushat e shkencave natyrore, matematikë dhe kapacitetin për të kuptuarit e leximit.²

Futja dhe aplikimi i testimit ekstern janë shumë të pranishme në diskursin shoqëror, kryesisht në mesin e aktorëve kryesorë, dmth. nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme mbi politikën e testimit ekstern, megjithatë, ka një pikë lidhëse në mes të gjitha pikëpamjeve kontradiktore, dhe kjo është konsensus për nevojën e ekzistencës së një instrumenti të tillë. Pikërisht ky konsensus i cili e gëzon testimi i ekstern rezultoi që si temë diskutimi të jet formati dhe mënyra se si do të zbatohet në mënyrë që të rriten efektet, dhe jo vetëm nevoja e këtij instrumenti. Në këtë drejtim, vlerësimi i testimit ekstern duhet të shihet vetëm përmes prizmit se sa dhe a kontribuon në përmirësimin e arsimit dhe adresimin e dobësive të cilat ekzistojnë.

Qëllimi i hulumtimit është të përcaktojë nëse vënia në funksion e politikës së testimit ekstern përmirëson objektivitetin e vlerësimit tek mësimdhënësit. Duke pasur parasysh se personat kompetent me zbatimin kësaj mase kishin për qëllim përcaktimin e shkallës së objektivitetit të personelit të mësimdhënësve, hulumtimi synon të bëjë të ditur perceptimin e të vlerësuarve (mësues dhe profesor) për përmbushjen e këtij qëllimi të caktuar. Duke matur perceptimin e të anketuarve mbi këtë temë do të fitohet pamje apo fotografi për lidhjen mes qëllimit të testimit ekstern, vendosur nga ana e hartuesve të politikave, si dhe përdoruesve të saj përfundimtarë: mësuesit dhe nxënësit. A është rritur objektiviteti në notim nga ana e mësimdhënësve? Cili është ndikimi i testimit ekstern tek nxënësit?

Hulumtimi kufizohet në notim ekstern në arsimin e mesëm sepse popullsia e përgjithshme e mësuesve dhe nxënësve në arsimin e mesëm është relativisht e vogël, e kështu

1 | Национална програма за развој на образованието во РМ 2005-2015, <http://goo.gl/h1ck3R>

2 | Literacy Skills for the World of Tomorrow further results from PISA 2000, OECD, 2000. <http://www.oecd.org/edu/school/2960581.pdf>

edhe përdorimi i metodave të mbledhjes së të dhënave është më i lehtë. Gjithashtu fillohet nga supozimi se niveli i përgjithshëm i pjekurisë dhe ndërgjegjësimit të natyrës së procesit arsimor është më i lartë në mesin e nxënësve në arsimin e mesëm në krahasim me nxënësit e shkollave fillore.

Kjo analizë e notimit ekstern në Republikën e Maqedonisë është strukturuar në këtë mënyrë: në pjesën e parë jepet një pasqyrë e koncepteve teorike që kanë të bëjnë me notimin apo vlerësimin ekstern; pjesa e dytë mbulon përvojën e Republikës së Maqedonisë në funksionin dhe aplikimin e testimit ekstern, dhe gjithashtu ofron një shqyrtim krahasues të përvojave të vendeve të tjera; më pas, në pjesën e tretë, shpjegon metodologjinë e hulumtimit dhe mbledhjen e të dhënave; në seksionin e katërt diskutohen rezultatet e hulumtimit dhe sondazhet, si dhe shpenzimet që bëhen në lidhje me testimin ekstern; dhe më në fund jipen konkluzionet dhe rekomandimet e notimit ekstern në arsim në Republikën e Maqedonisë.

II. KORNIZA TEORIKE


Notimi ekstern është një koncept i njohur në mesin e bartësve të politikave arsimore, por edhe në literaturë ku mund të vërejmë rritje të autorëve dhe studiuesve që në publikimet e tyre fokusi qëndror janë pyetje të lidhura me çështjen e politikës së notimit ekstern. Koncepti i notimit ekstern është përcaktuar kryesisht nga dy tipare të rëndësishme: i pari, tregon aspektin e notimit ekstern gjegjësisht ekzistenca e institucionit të jashtëm dhe të pavarur që kontrollojnë, monitorimin dhe / ose analiza e rezultateve të notimit në mënyrë që të sigurojë përgjegjshmërinë dhe përmirësimin e cilësisë; ndërsa tipari i dytë ka të bëjë me notimin aktual (testimin) të njohurive të arritura dhe aftësive të nxënësve.

Mungesa e një afati të unifikuar apo koncepti përgjithësisht të pranuar në nivel global ka çuar në atë që të përdoren terma të ndryshëm për këtë koncept, dhe të gjithë i referohen të njëjtës gjë, dmth testimit ekstern. Për këtë arsye, në literaturë më shpesh hasim termet «notim» (assessment) dhe «evaluim» (evaluation) dhe të njëjtat përdoren shpesh të pandryshuara. Megjithatë, literatura bën dallimin midis këtyre dy termave. Notimi i referohet procesit të vendimmarrjes, mbledhja dhe identifikimi i kushteve në fakte dhe prova në lidhje me arritjen e qëllimeve për të mësuarit të nxënësit dhe përfshin testimin e nxënësve brenda klasës, nëpërmjet notimit të brendshëm apo ekstern. Nga ana tjetër, vlerësimi përdoret për procesin e vendim-marrjes, mbledhjes dhe marrjes së vendimeve për sistemet, programet, materialet, procedurat dhe proceset (Harlen, 2007; OECD 2010).

Pavarësisht dallimit midis «notimit» dhe «evaluimit», në literaturë ka një dallim në mes të «vlerësimit sumativ» (summative assessment) dhe «vlerësimit formativ» (formative assessment). Gjegjësisht, përmes vlerësimit sumativ matet ajo që nxënësit kanë mësuar apo nuk kanë mësuar pas mbarimit të një viti shkollor të caktuar apo gjysëmvetorit; ndërsa vlerësimi formativ vlen edhe për vlerësimin e rregullt dhe interaktiv të progresit të nxënësve gjatë gjithë vitit, me qëllim për të identifikuar nevojat e mësimit, përkatësisht përshtatjen e mësimdhënies (OECD, 2010: 7). Me fjalë të tjera, vlerësimi sumativ përfshin përdorimin e testeve të standardizuara, dhe për të verifikuar njohuritë e nxënësve, promovimin e tyre, por edhe sigurim të përgjegjësive tek mësimdhënësit dhe shkollat për arsim cilësor. Nga ana tjetër, vlerësimi formativ është rezultat i marrëdhënieve ndërmjet nxënësit dhe mësuesit brenda në klasës gjatë gjithë vitit shkollor.



Për këtë arsye, mund të konkludohet se notimit ekstern në përgjithësi ka karakter përmbledhës duke injoruar tërësisht aspektin formativ vlerësues. Kjo në fakt paraqet dobësinë më të madhe të notimit ekstern pasi që vlerësimi duhet ti mer në konsideratë të dy aspektet e diskutuara më lartë, OECD si një organizatë që punon gjerësisht në fushën e arsimit, në analizat dhe raportet e saja tregojnë nevojën për njohjen e dy funksioneve të vlerësimit apo notimit: përmbledhës dhe formativ. Sipas OECD notimi i nxënësve në përgjithësi përfshin vlerësime të standardizuara kombëtare me qëllim të diagnostikimit dhe monitorimit dhe vlerësimit ekstern sumativ, sidomos në drejtim të notimit të nxënësve për çertifikim në arsimin e mesëm. Në nivel të shkollës, notimi i nxënësve luan një rol kyç në informimin e shkollave dhe mësimdhënësve për arritjet individuale të nxënësve nëpërmjet vlerësimeve përmbledhëse dhe formuese (OECD-së, 2013: 87).



Sa i përket asaj se si përdoren rezultatet e testeve, veçohet testimi me rëndësi të lartë (high-stakes testing) dhe testimi me rëndësi të ulët (low-stakes testing), terme të pranuar dhe përdorura më parë në Shtetet e Bashkuara. Ajo që e dallon testimin me rëndësi të lartë nga testimi me rëndësi të ulët nuk është forma, mënyra se si është projektuar testi, por funksioni i saj në aspektin se si përdoren rezultatet. Për shembull, në qoftë se rezultatet e testit përdoren për të përcaktuar rezultat të rëndësishëm në fund, të tilla si, a do të merr nxënësi çertifikatë për mbarimin e shkollës së mesme, testi konsiderohet si test me rëndësi të lartë. Ndryshe nga kjo, testet me rëndësi

të ulët zakonisht nuk sjellin implikime të rëndësishme për shkak të rezultateve të një natyre konsultative dhe shërbejnë vetëm për përdorim personal dhe vetëvlerësim tek nxënësi dhe / ose mësuesi.

Në kuadër të kësaj ndarjeje, testimi ekstern mund të karakterizohet si «testim me rëndësi të lartë» derisa për shembull, nota e marrur ndikon në notën mesatare të nxënësit gjegjësisht në mundësinë e promovimit të tyre dhe regjistrimi në nivelet më të larta të arsimit. Nga ana tjetër, «rëndësia e lartë» e testimit ekstern për mësuesit rezulton mundësinë e mirënjohjes dhe / ose dënimit të tyre, në varësi të rezultateve të arritura. Duke u nisur nga pasojat të cilat i shkaktojnë «testet me rëndësi të lartë», rëndësi të veçantë ka njohja e të ashtuquajturit «faktorët e rastësishëm» që janë jashtë kontrollit, por të cilat mund të ndikojnë në notën e testit dhe të shkaktojnë pasoja (jo) të drejta për nxënësit apo mësimdhënësit.

I pakundërshtueshëm është fakti se përdorimi i evaluimit ekstern në arsim është në ngritje apo përmirësim, i cili sipas analizës të OECD është për shkak të disa faktorëve:

- rritja e nevojës për efikasitetin, barazi dhe cilësi në arsim për të përmbushur sfidat ekonomike dhe sociale;
- tendencat drejt autonomisë më të madhe të shkollave, me të cilat nxitet nevoja e monitorimit të përshtatshëm të performancës së shkollave;
- Përmirësimi i teknologjisë informative që kontribuon në zhvillimin e formave të ndryshme të notimit të nxënësve me çka lehtësohet grumbullimi, ndarja dhe menaxhimi i të dhënave;
- nevoja për rezultate konkrete nga evaluimi i realizuar në kuadër të marrjes së vendimeve në bazë të dëshmive (OECD, 2010: 1).

Përgjatë mbështetjes së gjerë për vënien në funksion të notimit ekstern si një mjet modern në fushën e arsimit, luftë më e theksuar e argumentëve bëhet reth asaj se si është dhe nëse ka një efekt të vërtetë të evaluimit ekstern vis a vis përmirësimin e arsimit dhe rritjen e

njohurive dhe aftësive të nxënësve dhe sigurisht vlerësimi i tyre objektiv nga mësuesit. Për këtë arsye, një aspekt i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të vlerësimit ekstern është nevoja për harmonizimin e testeve me qëllim të mësimin (OECD, 2013: 76). Në të kundërtën, vlerësimi merr karakter formal, derisa ndikimi që pritet të realizohet plotësisht mungon.

Opinionet rreth çështjes për ndikimin e vlerësimit ekstern mbi cilësinë e arsimit janë të ndara, ndërsa argumentet janë njëlloj të vlefshme si nga kundërshtarët ashtu edhe nga mbështetësit e instrumentit. Në mesin e zëdhënësve për përfitimet e evaluimit ekstern mbi-zotërojnë shumë argumente, ndërsa veçohen këto në vazhdim:

● **Evaluimi ekstern është një mjet me të cilin shkollat dhe mësimdhënësit janë të ekspozuar ndaj raportimit të rregullt, si para institucioneve ashtu edhe para qytetarëve. Si rjedhojë e rezultateve të realizuara, përcaktohen mënyra se si do të shpërblehet suksesi dhe se a do të dënohen rezultatet e dobëta;**

● **Rezultatet e testeve paraqesin një «pasqyrë të gjakut» të detajuar për arsimin në një vend të caktuar ku dalin qartë në sipërfaqe progresi dhe dobësitë e politikave aktuale arsimore. Duke u bazuar në këtë pasqyrë, propozuesit e politikave mund të propozojnë rishikimin e politikave me qëllim që të hiqen mangësitë e identifikuara dhe sfidat;**

● **E fundit por jo me më pak rëndësi, vlerësimi ekstern konsiderohet si një mundësi ku nxënësit mund ta testojnë veten dhe njohuritë e fituara në lëndë të caktuara në periudha të caktuara akademike të testimit duke eliminuar notimin konvencional të cilit i ekspozohen rregullisht. Notimi ekstern është gjithashtu më objektiv në krahasim me notimin e rregullt në klasë pasi që i njëjti zbatohet në kompjuter ose nga persona të cilët nuk e njohin nxënësin personalisht, gjë që nuk ndodh me mësuesin dhe kështu nota mund të jetë subjektive apo e ndryshueshme. Ekziston konsensus i përgjithshëm se vlerësimi ekstern është çelësi për të ndërtuar sistem shkollor të fortë dhe të drejtë (OECD, 2013: 20).**

Siç e theksuam, edhe nga ana e kundërshtarëve të vlerësimit ekstern bashkëngjiten argumente të qëndrueshme të cilat janë njëlloj të vlefshme si ato të mbështetësve. Ndër listën e gjatë të kundër-argumenteve, zakonisht veçohen këto më poshtë:

● **Vlerësimi ekstern është burim i stresit të panevojshëm në mesin e nxënësve dhe presion mbi mësimdhënësit që mund të çojë në përkeqësimin e performancës së tyre dhe në përgjithësi të prodhojë efekte të kundërta nga ato të dëshiruara;**

● **Vlerësimi ekstern është një barrë shtesë financiare për buxhetin e shteteve të cilat zbatojnë testimin e tillë, ndërsa përfitimet në përmirësimin e njohurive të nxënësve dhe vlerësimin e tyre objektiv nga ana e mësimdhënësve nuk janë qartë të dukshme. Prandaj, i tërë procesi konsiderohet se nuk i tejkalon shpenzimet që rrjedhin nga një operacion i tillë në nivel kombëtar;**

● **Karakterit teknik dhe formal i këtyre testeve, p.sh. formati multiple choice (me rumbullaksimi) i pyetjeve dhe përqëndrimi i veçantë në të mësuarit e pyetjeve të cilat kanë më shumë gjasa të jenë pjesë e testimit i vë në pikëpyetje serioze besueshmërinë dhe rëndësinë e rezultateve në vlerësimin e gjerë dhe objektiv të nxënësve. Vlerësimi perceptohet më shumë si një test dhe matje se sa si mësim (OECD, 2013: 65). Ky problem është më i theksuar në vendet ku rezultatet e vlerësimit ekstern tërheqin implikacione mbi notën përfundimtar të nxënësit.**



Si përfundim, do të theksonim se në literature profesionale ekzistojnë pikëpamje divergjente mbi vlerësimin ekstern dhe efektet aktuale në procesin e edukimit. Megjithatë ka një pikë lidhëse midis të gjitha pikëpamjeve kontradiktore (gjegjësisht emërues I përbashkët), dhe kjo është konsensus për nevojën e ekzistencës së një instrumenti të tillë. Mu ky konsensus i gjerë që gëzon vlerësimi ekstern rezultoi që temë diskutimi të jetë formati dhe mënyra se si e njëjta do të zbatohet me qëllim që të maksimizohen efektet, dhe jo vetëm nevoja për këtë instrumenti.

III. PËRVOJA E MAQEDONISË ME TESTIMIN EKSTERN

Me hyrjen në fuqi të ligjit për vlerësimin ekstern në arsimin fillor dhe të mesëm në Maqedoni u pa e nevojshme dhe e domosdoshme që të krijohet një sistem modern, efikas dhe cilësor në të gjitha nivelet. Sipas bartësve të politikave, arsimit cilësor si qëllim përfundimtar në mënyrë të pashmangshme përfshin përmirësimin e objektivitetit në notim nga ana e mësimdhënësve.


Në mesin e qytetarëve ende egziston përshtypja se notat e nxënësve nuk janë mjaftueshëm objektive, ndërsa mënyra e notimit bazohet mbi a në aftësitë e nxënësve për të mësuar përmendësh faktet nga tekstet shkollore. Mes të tjerash, edhe pse nuk u bënë analiza gjithëpërfshirëse për nxënësit dhe pjesmarësit tjerë në sistemin arsimor, rezultatet nga testimet krahasuese të implementuara në vendet tjera dhe të nxënësve të Maqedonisë që kanë marrë pjesë në testimet ndërkombtare, dhanë sinjal të qartë se sistemit arsimor i duhet ndryshim i përmasave më të gjëra. Rezultatet e dobëta të nxënësve të Maqedonisë në testimin PISA në vitin 2000 ishin pikë kthyesë në vetvete. Në raportin e testimit përmendet se “mbi 50% e masës studentore në Maqedoni kanë arritur sukses me notën 1 nga nota më e lartë e mundshme 5. Kjo tregon se nxënësit e këtij vendi mund të ballafaqohen ekskulizivisht me detyrat elementare në lidhje me leximin”. Atë vitë, Maqedonia ishte ranguar në vendin e 30 nga 35 vendet konkurente. Aftësitë e nxënësve në atë periudhë janë vlerësuar teknikisht, në fakt, ekziston aftësi e dobët që të përdoret leximi si vegël për promovim dhe përhapje të dijes në sferat tjera. “Këto nxënës përballen me rrezikun e një tranzicion efektiv nga shkolla në tregun e punës dhe dështimi i mundshëm në kuadër të edukimit të vazhdueshëm”(Instituti për statistika UNESCO, 2000: 76).

Qasja serioze drejtë vënies në funksion të testimit ekstern është e dukshme në Strategjinë nacionale për zhvillim të arsimit 2005-2015³. Në dokumentet përmendet dyshim se notat shkollore nuk janë objektive dhe si të tilla nuk e tregojnë njohurinë reale të nxënësve. Mes arsyeve se pse notat janë jo reale ceket edhe shtypja që ju bëhet mësimdhënësve për të lënë nota (më të larta) jo reale (Udhëzues për testimin ekstern, 2013)⁴. Problemi i detektuar i notimit jo objektiv mbi të gjitha erdhi për shkak se sistemi arsimor nuk kishte të ndërtuar sistem bashkëkohor për siguri dhe kontrollë të testimit ekstern. Prandaj, qasja drejt ndërtimit dhe aplikimit të një sistemi bashkëkohor mu për këtë shkak u pa si nevojë e domosdoshme drejt realizimit të idesë për reforma të thella në arsim.

Është e rëndësishme të theksohet se testimi ekstern është pjesë e integruar e Programit për sigurim dhe kontrollë të kualitetit në arsim i cili është i konceptuar në mënyrë që të siguroj

3| <http://fvm.ukim.edu.mk/documents/Nacionalna-programa-za-razvoj-na-obrazovaniето-vo-Republika-Makedonija-2005-2015.pdf>

4| <http://www.mon.gov.mk/images/documents/eksterno/Ekterno-Vodich-Vest.pdf>



dhe garantoj cilësi në arsimin parashkollor, fillorë dhe të mesëm dhe është në përputhje me sistemet e vendeve të zhvilluara. Programi bazohet në një grup mekanizmesh për mes së cilave duhet të arrihet një sistem për sigurim dhe kontroll në cilësinë e arsimit, dhe më saktësisht përfshin: a) vënjen e standardeve si bazë për sigurim dhe kontrollë të cilësisë së dëshiruar, b) sigurim të kualitetit, si dhe c) vlerësim të kualitetit, që duhet të kryhet nëpërmjet vetëlartësimit, vlersimit nga jashtë, si dhe notat eksterne dhe testet .

Nevoja për gjetjen e mënyrave për sigurim dhe kontrollë të kualitetit u përforëcua edhe me procesin e decentralizimit që filloj në vitin 2005, nga i cili shkollat fituan autonomi më të lartë, ndërsa reparti i arsimit në masë më të madhe u bë nën ingerencat e pushtetit lokal. Kapacitetet e dobëta të komunave për të udhëhequr me sektorin e arsimit, sidomos në komunat e vogla, panë të nevojshme kontrollën dhe mbykqyrjen e rregullt të kualitetit të procesit arsimor nga pushteti qendror që të sigurohet aplikim i qartë i akteve ligjore dhe transparenca e tyre. Pë këtë arsye, intervenimi nga pushteti qendror nëpërmjet testimit ekstern konsiderohet si domosdoshmëri në kuadër të procesit të decentralizimit.

1. Përshkrim i shkurtër mbi vlerësimin ekstern në Maqedoni

Pjesët e strategjisë që ishin të lidhura me vlerësimin ekstern u shkrinë në vendime ligjore, në fakt reforma e ashtuquajtur “testim ekstern” ishte e inkorporuar dhe vendosur në Ligjin për shkollim fillor⁵ dhe të mesëm⁶. Kështu që, duke u bazuar në Ligjin për shkollimin fillor dhe Ligjin për shkollim të mesëm organizimi dhe zbatimi i testimit ekstern ishte nën ingerencat e Qendrës Shtetërore për Provime. Përkrah Qendrës Shtetërore për Provime, në organizimin dhe zbatimin e notimit të kyqur edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Biroja për zhvillim të arsimit, Qendra për arsim profesional dhe trajnime si dhe Inspektoriat shtetëror për arsim.


Testimi ekstern si pilot projekt u implementua në një mostër të caktuar në vitin shkollor 2010/2011 në teritorin e Maqedonisë, kurse në 2011-2012 filloi të pranohet plotësisht nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Përkohësisht, kontrollimi ekstern I të arriturave të nxënësve të klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë gjegjësisht nga viti i parë deri në të tretin realizohet në fund të çdo viti shkollor, për çka Qendra Shtetërore e Provimeve siguron aplikacion me teste prove me të cilat nxënësit do të mund ti ushtrojnë. Testet nga kontrollimi ekstern përpilohen nga Qendra Shtetërore e Provimeve, si propozim nga Biroja për zhvillim të arsimit.

Testimi ekstern i arritjeve të nxënësve bëhet në dy lëndë mësimore, në pajtueshmëri me plan programin, ndërsa bazohet në orarin e përgjithshëm të përpiluar nga Qendra Shtetërore e Provimeve, me propozim nga Biroja për zhvillim të arsimit, përveç lëndëve tek të cilat nxënësit fitojnë aftësi. Rezultatet e fituara nga testimi ekstern shkruhen në vend të

5| Закон за основното образование консолидиран текст („Службен весник на Република Македонија“ бр. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 и 30/2016)

6| Закон за средното образование, консолидиран текст („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 и 30/2016)

veçantë në deftesë dhe janë kriterium kyç për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm apo të lartë. Në plan të parë gjatë shpalljes së rezultateve të vlersimit ekstern dhe suksesit të nxënësve është notimi i objektivitetit dhe profesionalizmit të mësimit gjatë vlerësimit të njohurive të arritura të nxënësve. Notimi i mësimit bëhet duke krahasuar arritjet e nxënësit në një lëndë të caktuar, për të cilën Qendra Shtetërore e Provimeve përgatit raport të përgjithshëm, me rezultatet e zbatimit të testimit ekstern për matjen e njohurive të arritura të nxënësve. Me ndihmën e një metodologjije të posaçme, konfirmohen dallimet midis notave që kanë marrë nga mësimit dhe ato nga testimi ekstern dhe varësisht se sa të mëdha janë devijimet apo dallimet janë parapa sanksione apo dënime (për devijimet më të mëdha), gjegjësisht mirënjohje për mësimit notat e të cilëve nuk dallojnë nga notat e testimit ekstern.



Kjo do të thotë se, çdo mësimit i mbledhen devijimet totale, ndërsa Qendra Shtetërore e Provimeve përgatit një rang listë për devijimet e të gjithë mësimit në vend. Duke u bazuar në atë listë, tek 20% e mësimit tek të cilët ka devijimet më të vogla është rritur paga mujore për 15%, kurse tek 20% e mësimit tek të cilët ka devijime apo dallime më të mëdha (nda dy nota) do të dënohen me zvogëlimin e pagave për vitin e ardhshëm me 15% dhe ju sigurohet ndihmë profesionale nga Biroja për zhvillim të arsimit. Nëse mësimit tre vjet rradhazi hyn në grupën e 20% të mësimit me devijime më të vogla, atëherë parashikohet avancim në vendin e punës, mirëpo rasti i kundërt (tre vjet rradhazi në grupën e 20% të mësimit me devijime më të mëdha) do të sjell ndërprerjen e punësimit. Këtu, veçanërisht do të theksonim se edhe pse dispozitat e mësipërme që çojnë në dënim gjegjësisht në mirënjohje të mësimit kanë vlefshmiri ligjore, prap se prap aplikimi i tyre është shtyrë disa herë me ndryshimet përkatëse ligjore..

Kontrollimi ekstern përbëhet nga një test i cili është i përbërë nga 30 pyetje dhe zgjidhet në mënyrë elektronike ku ofrohen më shumë përgjigje. Me këtë përmbushen standardet për testimin e projektuar për të kontrolluar kujtesën, mirëpo lihen anash teknikat për kontrollimin e aftësive dhe shkathtësive për aplikimin e njohurive të marrura. Si shtesë, pyetjet shpallen pikëpikë në ueb-faqen e Qendrës Shtetërore për Provime, tri ditë para testimit. Me këtë, në njëfarë mënyre bëhet një lloj barazimi në mes të nxënësve me sukses të lartë të vazhdueshëm dhe atyre që kanë sukses më të dobët, pasi që është lënë një hapësirë e madhe për të mundur “materialin” dhe të fitohet notë e lartë edhe tek nxënësit më të dobët, gjë që inicon në subjektivitet të maskuar në vetë vlerësimin ekstern. Mësimit gjithmonë tentojnë që të lënë nota mesatare me pretekst se nuk do të dënohen në të ardhmen. Pa spekulime, kjo do të nënkuptonte devijim nga nota që e ka vendosur mësuesi, e që këtej, me qëllim që të mbrohen, mësimit këmbëngulin në vënien e notave mesatare të cilat zvogëlojnë devijimin dhe shmangin dënimin e mundshëm.

Aspekti teknik i organizimit të testimit shpesh ballafaqohet me probleme, të tipit si rrënja e sistemit elektronik, lëshime softverike ku përsëriten pyetjet, pyetje jo logjike, vonesë me testin, etj.



2. Kushtetuta dhe testimi ekstern

Kontestimi i testimit ekstern u shënuar që nga përpjekjet e para që ajo të vihet në funksion. Mos përgatitja e mësimdhënësve, hyrja në fuqi e ligjit të testimit ekstern pa konsultime paraprake me palët e interesuara, dhe shkelja e parimit themelor gjatë vënies në funksionin e testimit ekstern, dmth “vlerësimi ekstern të pranohet nga publiku (Strategjia për zhvillimin e arsimit, 2005:392)”, ishin arsye të mjaftueshme për kontestimin e vlerësimit ekstern.

Dispozitat ligjore me të cilat u vu në funksion testimi ekstern ishin të vendosura pranë Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 që të kihet në konsideratë kushtetuetshmëria e tyre. Pas rishikimit, gjykata doli me vendimin⁷ që të suspendohen në kohë këto dispozita dhe testimi ekstern të shtyhet për një vit. Në vendim, mes të tjerash u dha edhe arsytimi si në vijim: “Sipas gjykatës, organ i pushtetit ekzekutiv, jashtë shkollës dhe edukimit – sistemi arsimor, nuk mund të bëhet kontrollimi dhe notimi i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, gjegjësisht se nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe principet e qeverisjes së drejtësisë, ministria e arsimit dhe Inspektorati shtetror i arsimit duhet të organizojnë dhe implementojnë kontrollë të suksesit të nxënësit, e cila është në ndikimin e suksesit përfundimtar të nxënësit. Me një fjalë, sipas sistemit arsimor, zbatimi i procesit arsimor dhe konfirmimi i suksesit të përgjithshëm të nxënësit, e zbatojnë organet kompetente arsimore”. Kjo të drejton tek pjesa ku me reformën është parapara përcaktimi i suksesit të përgjithshëm të nxënësit nga ana e organeve të cilat nuk janë nga vetë shkolla, ndërsa ajo është e diskutueshme dhe nuk është në përpuethshmëri me Kushtetutën, dhe me ndryshimet e vitit 2010, testimi ekstern realizohet nga ana e shkollave.

Me këtë, si qëllime të kësaj reforme veçohen:

- **Dhënia nxënësve mundësinë që të njohin njohuritë e tyre, dmth vetë reflektim;**
- **Dhënia mësimdhënësve mundësinë për të shqyrtuar objektivitetin e tyre në notim.**

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ndikoi edhe në zbutjen e diskursit të përkrahësve të ligjit të testimit ekstern, evidente nga qëndrimi i anëtarit të MON-it, i cili tha: “Kontrollimi ekstern i suksesit të nxënësve duhet të shtyhet për vitin 2011-2012 edhe përskaj asaj që ishin ndërmarrë hapa konkrete për implementimin e testimit dhe ishin sjellë të gjitha aktet nënligjore. Miërpo, gjatë kontaktit me shkollat erdhëm në përfundim se mësimdhënësit dhe nxënësit nuk janë mjaftueshëm të informuar për procesin e kontrollimit ekstern dhe se është e nevojshme tu jipet kohë nxënësve që të përgadite për testimin ekstern që të mund ta pranojnë atë më mirë. (Stojanovski, 2011).

Përvoja e deri tanishme me implementimin e testimit ekstern tregon se publiku ende ka rezerva rreth mënyrës se si bëhet i gjithë ky proces. Si rikujtim, Strategjia 2005-2015 kërkonte themelimin e testeve eksternë në Maqedoni të cilat do të mundësojnë shtetit të ketë informacione më valide dhe objektive për arritjet e nxënësve dhe faktorët arsimor të cilët kanë ndikuar në të njëjtat, por edhe të ndiqen trendet e



7| http://bro.gov.mk/docs/zakonodavstvo/sredno/Odluka_na_Ustaven_sud_Zakon_za_Sredno_obrazovanie_01072009.pdf

respektimit të standardeve. Këto informacione duheshite të shërbejnë për marrjen e vendimeve në politikat në arsim të themeluara në bazë të gjendjeve reale dhe nevojat në praktikat arsimore, si dhe ndarjen e resurseve në sistemin arsimor.

Prej këtu dalin pyetjet që parashtrihen më shpesh:

● **cila është logjika nëse mësimdhënësi bën ndjekjen interne të njohurive të nxënësve gjatë gjithë vitit shkollor që në fund nota e testimit ekstern të ketë vlerën e njejtë dhe implikimet e njejtë mbi suksesin e nxënësve dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve?**

● **Përse rezultati nga testimi ekstern ndikon në notën e nxënësve? Nota e çdo nxënësi rritet duke marrë parasysh parametrat objektive dhe subjektive. Secila notë në vete përmban elemente të zhvillimit individual të nxënësit, arritjet e kapaciteteve maksimale, një shumë e indikatorëve të punës që bëhet gjatë gjithë vitit, angazhimi, ballafaqimi me materialin. Nuk mundet e gjithë kjo të fshihet me një test të vetëm i cili mun të mos jetë tregues për shkak të elementeve aktuale dhe subjektive.**

● **A konsiderohen rezultatet e testimit ekstern si njësi matëse se a meriton një mësimdhënësi të mer parapërshtim në qoftë se dy vite me radhë devijon me dy nota?**

● **si metoda konkrete e përcaktimit të objektivitetit të notimit dhe sistemit të vendosur për mirënjohje dhe dënim do të kontribuojë në proces më të mirë arsimor?**

Çelësi për reformat e suksesëshme është në qasje serioze me ato, involvimi i palëve të interesuara në të gjitha aspektet e vendim-marrjes dhe informimi i tyre në kohë për të gjitha ndodhitë të cilat rrjedhin nga reforma të veçanta me qëllim që të fitohet mbështetja e tyre për ndryshimet e propozuara. Adoptimi i politikave të cilat janë të lidhura fort me një sektor të ndjeshëm siç është arsimi, sipas përvojave të reformatorëve më të suksesëshëm ajo zgjatë edhe deri në 5 vjet. Në fund të fundit, çdo përsheptim në këtë drejtim automatikisht ndikon në zgjedhje jo të informuar (uninformed choice) për vendimin dhe politikat dhe të njejtat, në mënyrë të pritur, japin rezultate dhe efekte të kundërta me atë që është parashikuar.

3. Përvojat nga vendet tjera

Vlerësimi ekstern është i pranishëm në më shumë shtete si dhe numri i shteteve që duan të aplikojnë këtë sistem është në rritje, ndërsa ndër pionerët që kanë pasur sukses në implementimin e këtij sistemi janë SHBA, Australija, Britania e Madhe, Finlanda dhe Austia. Në vijim do të kemi një analizë krahasuese më ndodhitë në Finlandë si njëra nga vendet më të suksesëshme në kualitetin arsimor, si dhe Sllovenia e cila është e krahasueshme me Maqedoninë në disa/ më shumë sfera. Analiza përfshinë shpjegim të shkurtër të aplikimit të politikës së vlerësimit ekstern gjegjësisht mënyra e organizimit të testimit, pranimi i rezultateve si dhe mënyra e përdorimit të tyre, si dhe ndikimi i testimit ekstern në sistemin arsimor në ato vende. Gjatë përpunimit të kësaj analize krahasuese pajisemi kryesisht me analiza me tema të vlerësimit ekstern të punuara nga ana e OECD në vitin 2010 dhe 2013⁸.

8| <http://www.oecd.org/edu/school/oecdreviewonevaluationandassessmentframeworksforimprovingschooloutcomescountryreviews.htm>

Kur flitet për vlerësimin e njohurive të nxënësve, i pa shmangshëm është shembulli i Finlandës, si vend i cili është i ranguar në vend të parë në të gjitha testimet ndërkombëtare bile edhe para vendeve si SHBA, Britania e Madhe, Australija si dhe të gjitha vendet tjera të Bashkimit Evropian. Krejtësisht e merituar, sistemi arsimor i Finlandes tashmë paraqet një benchmark vetvetiu për të gjitha vendet me sistem arsimor të dobët apo jo funksional. Qasja ndaj arsimit në Finlandë është mjaft e ndryshme nga rrjedha e reformës e cila zbatohet në Maqedoni dhe në vendet tjera të rajonit. Sa për ilustrim, në Finland nuk ekziston testim ekstern formal dhe i unifikuar për të gjithë nxënësit. Testimi i vetëm ekstern që implementohet është ad hoc në mostë të ndryshme të nxënësve, ndërsa qëllimi është që të vërtetohet funksionimi i sistemit arsimor në tërësi, derisa përgjegjësia për vlerësimin e njohurive të nxënësve bie mbi mesimdhënësit. Nga mesimdhënësi pritet ti vlerësoj nxënësit në mënyrë permanente duke u bazuar në planin mesimor kombëtar si dhe në librat adekuate. Si plotësim i kësaj, mesimdhënësi është i obliguar që tu ndihmon nxënësve ti mësojnë teknikat për vetë-vlerësim (self-assesment) që të jenë në rrjedha me progresin e tyre personal gjatë të mësuarit materialin shkollor . Në pjesën më të madhe të shkollave, vetë-vlerësimi nxitet që nga klasa e parë⁹.

Në grupin e vendeve të suksesëshme bën pjesë edhe Slovenia. Në këtë vend, si për shembull, monitorimi mbi kualitetin e testimit ekstern bëhet me ndihmën e testimit ekstern kombëtar të nxënësve¹⁰, e cila oragnizohet dy herë, dhe atë: në fund të ciklit të dytë të shkollimit fillor edhe atë në mënyrë vullnetare; dhe në fund të ciklit të tretë të arsimit fillor, mirëpo këtu vlerësimi është i domosdoshëm për të gjithë nxënësit. Është teresante të theksohet se rezultatet e testimit ekstern janë të natyrës informative dhe vlerë për mesimdhënësit, prindërit, dhe vetë nxënësin, ndërsa të njejtat nuk kanë zë në formimin e notës përfundimtar të nxënësit.

Për dallim nga Republika e Maqedonisë ku fokusi është mbi kuadrin arsimor dhe kontrollimin e tyre, në Slloveni është i zgjeruar spektri i qëllimeve në fushën e në vlersimit ekstern, siç janë:

- **Kontributi në përmirësimin e cilësisë së arsimit, mesimdhënies dhe njohurive;**
- **Notim i arritjeve të standardeve të njohurive të cilat të shënuara në programet arsimore;**
- **Kontribut në aplikimin e kuptueshëm të metodave të ndryshme në mesimdhënie si dhe krijimi i një baze për mundësi të barabarta arsimore për të gjithë nxënësit;**

Zhvillimin e aftësive të nxënësve për vetë-reflektim në arritjet e tyre personale dhe vendosja e kriteriumeve për të njejtat.

Edhe pse sipas Programit kombëtar për zhvillim të arsimit në Republikën e Maqedonisë qëllimi në pjesën e Kontrollimit të kualitetit është i ngjajshme si ai i Sllovenisë, metodologjija dhe praktika e deritanishme me testimin ekstern treguan se qëllimet që u përmendën më lartë (në Slloveni), të cilat duhet të aplikohen edhe në rastin e Maqedonisë, nuk u arritën për shkak të fokusit të ngushtë të testimit ekstern mbi mesimdhënësit dhe të ashtuquajturin "frikësim" të tyre, të kihet kujdes (vetëm) në objektivitetin e e vënies së notave.

9| Finland: Slow and Steady Reform for Consistently High Results, OECD, 2010. <https://www.oecd.org/pisa/pisaproducts/46581035.pdf>

10| Education in Slovenia, European Commission, 2013. http://ec.europa.eu/europeaid/education-slovenia_en

IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Sipas hartuasve të politikave në arsim, implementimi i testimit ekstern (variabël e pavarur: testim ekstern) ka për qëllim t'a përmirësoj objektivitetin e notimit nga ana e mësuesve që do të kontribuojnë për arsim më kualitativ (variabël e varur: objektivitet dhe kualitet). Hulumtimi kufizohet tek testimi ekstern në shkollimin e mesëm sepse popullata e përgjithshme e ligjëruesve dhe nxënësve në arsimin e mesëm është relativisht më e vogël, ndërsa së bashku me atë është më e thjeshtë edhe përdorimi i metodave të mbledhjes së të dhënave. Gjithashtu, hiqet prej supozimi që niveli i përgjithshëm i pjekurisë dhe vetëdijës për natyrën e procesit arsimor është më i madh tek nxënësit në shkollimin e mesëm krahasuar me nxënësit e shkollimit fillor. Në kuadër të hulumtit të politikave të testimit ekstern, përdoren metodat e mëposhtme për të bërë mbledhjen e të dhënave:

- a. **Mbledhjen e të dhënave primare nëpërmjet intervistave gjysëm-strukturore (përgatitjen e anketave) në verzion të përgatitur dhe kushtuar pikërisht profesorëve dhe nxënësve; dhe**
- b. **Analiza e të dhënave sekondare - shfrytëzimin e të dhënave nga hulumtimet e mëhershme, analiza, si dhe debate në mediumet elektronike në lidhje me testimin ekstern;**
- c. **Diskutime me palët e interesuara - për kontrollim dhe përmbushje të përfundimeve preliminare.**

1. Pyetësi gjysëm-strukturor - verzioni i profesorëve dhe nxënësve

Përdorimi i metodave kualitative faktikisht anketave gjysëm-strukturore për mbledhjen e të dhënave vjen nga vetë natyra e variabëlave të varura. Fitohet përshtypja që është e pamundur të jipet nota e "objektivitetit të notimit" ose "kualitetit të arsimit" që më tej të përputhet me të dhënat dhe informacionet për perceptimet, mendimet dhe përvojat personale të palëve të interesuara në arsim faktikisht në procesin e notimit - profesorët dhe nxënësit. Si shtesë, përmbledhja e të dhënave nëpërmjet anketave mirret si e arsyeshme duke pasur parasysh madhësinë e formularit, faktikisht popullatës së përgjithshme të profesorëve dhe nxënësve në arsimin e mesëm. Prej këtu, ishin përgatitur dy anketat specifike të gjysëm-strukturuara drejtuar profesorëve në shkollat e mesme (shembulli 1) respektivisht për nxënësit e shkollave të mesme (shembulli 2), me qëllim përmbledhjen e të dhënave për ndikimin e notimit ekstern ndaj objektivitetit të notimit dhe kualitetit të arsimit. Në përgatitjen e anketës janë kyçur organizata qytetare përkatëse në këtë fushë që janë aktive në sektorin e arsimit respektivisht janë marrur parasysh vërrejtjet rreth përmbajtjes dhe strukturës së anketës. Janë bërë edhe disa tentativa për takime pune me përfaqësues të MASH-it, si dhe është bërë kërkesë zyrtare për të pasur qasje në shkollat dhe distribuim të anketave, por nuk u tregua përgatitje për mbështetje ose bashkëpunim në përmbledhjen e të dhënave për shkak obligimeve që kishin të bëjnë me implementimin e testimit ekstern.

Gjithashtu, para se të fillohet me shpërndarjen e anketave dhe përmbledhjen e të dhënave të vërteta, u zbatua një hulumtim kontrollues (pilot) tek disa

profesor respektivisht nxënës të shkollave të mesme, me qëllim të marrjes së vërejtjeve eventuale në lidhje me procesin respektivisht përmbledhjes dhe strukturës së anketave. Anketat janë anonime dhe janë strukturuar në këtë mënyrë: të dhëna demografike për të anketuarin, pyetje lidhur me ndikimin e testimit ekstern ndaj kualitetit të arsimit (vetëm për profesorët). Një pjesë e madhe e anketave janë të mbyllura me mundësi për zgjedhje të disa përgjigjeve të ofruara, derisa, numër më i vogël i pyetjeve janë të hapura dhe japin mundësi për shprehje të qëndrimeve, perceptimeve dhe mendimit të të anketuarve në lidhje me temën e hulumtimit. Të gjitha pyetjet janë neutrale dhe nuk sygjerojnë zgjedhje të një përgjigjeje konkrete. Dhe më shumë, tek pyetjet e mbyllura neutraliteti është i përforcuar me mundësinë për zgjedhje të përgjigjes “nuk e di”, “nuk kam ide” ose “mendim tjetër”.

Të dhënat, respektivisht përgjigjet e pyetësorëve mbli-dhen me përdorimin e një mjeti konkret dhe specifik - online pyetësor që siguron anonimitet të plotë dhe besim të procesit nga njëra anë, megjithatë, në lidhje me “anshmërinë në zgjedhje” paraqet kufizim nga aspekti “validitet i brendshëm”¹¹. Më parë, me ndihmën e organizatave qytetare në shumë qytete, u realizua komunikim me një pjesë të nxënësve dhe profesorëve të cilët u informuan me qëllimet bazë të hulumtimit, poashtu edhe me periudhën kohore në të cilën do mundën me vetëdëshirë të përgjigjen në pyetësorin online. Këtu, do kishim cekur që periudha kohore e implementimit të hulumtimit u ndesh me periudhën e implementimit të testimit ekstern dhe pas asaj, ekziston mundësia e ndarë për të përforcuar përgjigjet negative nga fakti i intensitetit të madh të emocioneve tek profesorët dhe nxënësit që mund të ndikojë si një rrezik për “validitetin e brendshëm” të eksperimentit. Si rezultat i saj, të dhënat mund të shihen në një formë maksimale. Ky trend mund të ketë me vete një ndikim të padyshimtë ndaj përgjigjeve të një pjese të pyetjeve, mirpo nuk paraqet ndonjë kufizim të madh sepse të dhënat janë fituar në një formë të burimit të vërtetë dhe të freskët me të gjitha problemet e mundshme që paraqiten gjatë notimit dhe testimit. Kjo situatë do mund të kalohet me organizimin e një fokus grupi që një pjesë e pyetjeve, gjatë vitit akademik, disa muaj pas kalimit të testit, ndërsa qëllim bazë do jetë marrja apo përmbledhja e informatave shtesë.



2. Analiza e të dhënave sekondare

Në kuadër të përmbledhjes së të dhënave sekondare që janë relevante me këtë hulumtim, implementohen analizat e mëposhtme:


- **Analizohet korniza e përgjithshme juridike dhe institucionale e arsimit, ndërsa para se gjithash janë dispozitat që kanë të bëjnë me notimin ekstern dhe institucionet që janë kyçur në procesin e testimit ekstern;**
- **Analizohen përvojat krahasuese të shumë vendeve në pjesën e politikës arsimore dhe ndryshimi i modeleve për kontroll dhe avancimin e kualitetit të arsimit;**
- **Analizohen konkludimet nga hulumtimet e mëparshme të kryera në fushën e arsimit nga ana e shkencëtarëve apo institucioneve relevante.**

11 | Cook and Campbell (1979), Quasi-Experimentation (pg 5).

3. Diskutim me palët e interesuara

Si nevojë e diskutimit shtesë lidhur me të dhënat primare dhe sekondare, si dhe konkludimeve të dorëzuara preliminare dhe rekomandimeve, organizohet një diskutim me grupet e interesuara - organizata dhe institucione që punojnë në sektorin e arsimit. Në vetë takimin prezentohen konkludimet preliminare dhe hapet një debat i gjerë për përmbushjen e rekomandimeve të shtruar në debat dhe bëhet finalizim të dokumentit që do të shpërndahet deri tek institucionet kompetente dhe kreatorëve të politikave të fushës së arsimit. Me të njëjtat do të realizohen edhe takime të ndryshme për afrimin e dokumentit dhe diskutim rreth rekomandimeve të dhëna.

V. ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT - KONSTATIMET NGA HULUMTIMI DHE ANKETA E ZBATUAR TEK NXËNËSIT DHE MËSIMDHËNËSIT



Të gjeturat nga hulumtimi të diskutuara dhe të prezantuara më poshtë janë të bazuara në përgjigjet e 598 nxënësve në shkollat e mesme shtetërore në Republikën e Maqedonisë, si dhe 227 mësime dhënëse të cilët iu përgjigjën pyetësorit elektronik në periudhë nga maji deri në korrik 2016. Këto numra parqesin një vëllim të mirë të mostrës pasi që ata përfaqësojnë një përfshirje rreth 0.7% të popullsisë së nxënësve (598 nga gjithsej 81,788 nxënës në vitin 2016), ndërsa numri i mësime dhënëse të përfshirë është më i madh dhe arrin deri në 3.1% (227 nga gjithsej 7345 mësime dhënëse në arsimin e mesëm).


Struktura e gjinisë, moshës dhe etnicitetit të nxënësve dhe mësime dhënëse është paraqitur në grafikonët e mëposhtëm. Sa i përket shpërndarjes rajonale të përgjigjeve, një pjesë e madhe e nxënësve dhe mësime dhënëse të cilët iu përgjigjën pyetësorit janë të shkollave të mesme të vendosura kryesisht në rajonin e Shkupit, Pollogut, jugperëndimorë, rajonin verilindor, duke përfshirë edhe një numër të vogël të të anketuarve nga shkollat e rajoneve të tjera.

Sa i përket lëndëve, përfaqësimi i mostrës është i përshtatshme duke mbuluar një pjesë të madhe të programit mësimor të shkollave të mesme dhe atë: matematikë, gjuhë antare, gjuhë angleze, biologji, fizikë dhe lëndët tjera në kuadër të vlerësimit ekstern¹². Sa i përket programit mësimor një pjesë e madhe në fushat e programit arsimor të shkollave të mesme janë të mbuluara ashtu që përfaqësimi i mostrës është në nivel të pranueshëm. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga nxënësit dhe mësime dhënësit të cilët janë përgjigjur pyetësorit, në vazhdimësi të analizës, ne kemi diskutuar disa pyetje të rëndësishme në lidhje me sistemin e vendosur të vlerësimit ekstern në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë.


12| Листа на наставни предмети од средно образование со развиени стандарди за оценување <http://bro.gov.mk/?q=gimnazisko-obrazovanie-standardi>

GRAFIKON 1

A




● Mashkull
● Femër




● Maqedonase
● Shqiptare
● Turke
● Rome
● Sërbe
● Vllahe
● Boshnjake
● Tjetër

Gjinia dhe përkatësia etnike e nxënësve

B




● Mashkull
● Femër




● Maqedonase
● Shqiptare
● Turke
● Rome
● Sërbe
● Vllahe
● Boshnjake
● Tjetër

Gjinia dhe përkatësia etnike e mësimitdhënësve

C



● Viti i parë
● Viti i dytë
● Viti i tretë
● Viti i katërt




● Deri 25 vjet
● 26-33
● 34-41
● 42-49
● 50+

1. Qëllimi i politikës së testimit ekstern

Qëllimi deklarativ i vlerësimit ekstern është që të kontrollojë objektivitetin e notimit nga ana e mësimit dhe nxënësve. Sipas institucioneve shtetërore të cilat krijojnë politika arsimore, me hyrjen në funksion të vlerësimit ekstern pritet “që të zbuten shtypjet të cilat i vuajnë mësimit për të lënë nota inflacionuara, më si dhe të përmirësohet cilësia e arsimit”¹³. Poashtu, në bazë të Ligjit për arsim të mesëm, “në bazë të rezultateve të kontrollimit ekstern të të arriturave të nxënësve vlerësohet objektiviteti dhe profesionalizmi i mësimit në vlerësimin e arritjeve të nxënësve” (neni 70a).

Në këtë kontekst, rezultatet e hulumtimit tek nxënësit tregojnë se 2/3 e të anketuarve thonë që mësimit në mënyrë reale dhe objektive vlerësojnë, në fakt i notojnë nxënësit në bazë të njohurive që i tregojnë gjatë orëve mësimore. Kjo do të thotë se se ka hapësirë për ta përmirësuar notimin apo vlerësimin, mirëpo përshtypja e lënë është se një numër i madh i nxënësve të nuk e vërejnë notimin jo objektiv si problem i cili duhet të targetohet dhe të zgjidhet nëpërmjet politikës së testimit ekstern.

GRAFIKON 2



A i vlerësojnë mësimit nxënësit në bazë të njohurive të marrura gjatë orëve mësimore? (Përgjigjet e nxënësve)

Si duket lidhja në mes objektivitetit në notim dhe kualitetit të arsimit është mbivlerësuar. Pohimi se objektiviteti në notim çon drejt përmirësimit të kualitetit nuk është gabim, mirëpo i injoron faktorët tjerë të cilët kontribuojnë në përmirësimin e kualitetit në arsim.

Vendimi aktual dhe aplikimi i vlerësimit ekstern ofrojnë fokus të pjesërishtëm të rezultateve në arsim (njohuritë e fituara të nxënësve), mirëpo pothuajse plotësisht i neglizhon inputet (nxënësit, familjen, gjendjen ekonomiko-sociale të tyre) dhe vetë procesin e arsimit (kualiteti i mësimit, kushtet e mësimit, krijimi i atmosferës kreative). Edhe më shumë, fokusi ndaj rezultateve është i pjesërishtëm sepse kufizohet vetëm në devijimet në notim, por jo edhe nivelin të njohurive të marrura tek nxënësit. Që ketu, mund të vijmë në përfundim se është e nevojshme të rivedinohen qëllimet e testimit ekstern dhe lidhja e tyre me qëllimin përfundimtar- përmirësimi i kualitetit arsimor.

Si vërtetim i asaj që është shënuar, rezultatet e fituara nga hulumtimit mbi ndikimin e testimit ekstern në kualitetin arsimor tregojnë se 83% e mësimit thonë se testimi ekstern aspak nuk ka ose ka pak ndikim në përmirësimin e kualitetit arsimor, përderisa 62% e mësimit janë të mendimit se testimi ekstern nuk ka aspak ndikim në mësim dhe njohuritë e marrura të nxënësve. Më tutje, 77% e mësimit thonë se me aplikimin e testimit ekstern nuk asnjë përmirësim në arsim.

13 | Водич за екстерно тестирање (<http://mon.gov.mk/images/documents/eksterno/Ekterno-Vodich-Vest.pdf>)


2. Zgjedhje e instrumenteve/ masave të duhura për arritjen e qëllimit të caktuar

S hfrytëzimi, i vetëm, i rezultateve të testimit ekstern të nxënësve është i pamfjautëshëm dhe jo i plotë për arritjen e qëllimit të caktuar - notim objektiv dhe real. Në bazë të rezultateve të gjeneruara nga hulumtimi, 3/4 e të anketuarve tek nxënësit, në fakt deri 80% e mësimdhënësve, janë të mendimit se testimi ekstern nuk ka asnjë ndikim tek mësimdhënësve mbi objektivitetin në notim.

Nga rezultatet e marrura, fitohet pershtypja se testimi ekstern në bazë të perceptimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, ka ndikim jo të vyshem për arritjen e qëllimit të caktuar. Në drejtimin e njëjtë, në bazë të hulumtimeve të OECD të bëra në më shumë vende të zhvilluara, është e nevojshme që të aplikohet një sistem multidimensional i cili e vlerëson objektivitetin dhe profesionalizmin e mësimdhënësve në bazë të më shumë dimensioneve, dhe jo vetëm rezultatet e testimit ekstern.


Kombinimi i më shumë dimensioneve në notim i mësimdhënësve bëhet për shkak të validitetit problematik të notave nga testimi ekstern të cilat mund të japin pasqyrë të keqe nëse përdoren si indikator i vetëm për objektivitetin në notim (nëpërmjet matjeve të devijimeve me notën e testimit ekstern). Si duket ka lidhje reciproke mes të objektivitetit (besueshmërisë) dhe validitetit në notim, në fakt me testimin ekstern do të rritej, deridiku, objektiviteti i notës (do të standardi-

GRAFIKON 3



Me implementimin e testimit ekstern, cilat janë pjesët në të cilat mendoni se ka PËRMIRËSIM? (Përgjigjet e mësimdhënësve)?

GRAFIKON 4




Nxënës (në të majtë), mësimdhënës (në të djathtë)

zohen notimet midis shkollave dhe rajoneve të ndryshme), mirëpo zvogelohet validiteti saj.

Sipas kritikuesve të vlerësimit ekstern, notat eksterne kanë munges të validitetit pasi që vlerësojnë të mbajturit mend të të dhënave përkundër diturisë, në fakt e testojnë vetëm të mbajturit mend, por jo edhe “kuptimin, aplikimin, analizën, sintezën, vlerësimin dhe kreativitetin” në pajtueshmëri me kriteriumet për notim të Biros për zhvillim të arsimit¹⁴ dhe Taksonomisë së Bloom. Këtu patjetër të theksohet se BZHA përsëri kriteriumeve për notim ka të krijuar edhe Standarde për notim për të gjitha zonat e programeve në bazë të nivelit të diturisë dhe aftësive (Taksonomija e Bloom¹⁵). Së dyti, testimi ekstern bazohet në notim të njohurive të caktuara, përderisa nota e mësimdhënësit paraqet agregat i cili formohet gjatë ndjekjes së nxënësit gjatë gjithë vitit shkollor dhe vlen për të gjithë materialin mësimor. Kështu, formimi i notës përfundimtare varet prej të arriturave të nxënësit në bazë të kriteriumeve të cilat mund të pasqyrohen vetëm përmes një procesi të vazhdueshëm dhe të vlerësohet sipas të njejtave. Në fund, nota e testimit ekstern paraqet “incident”, në fakt e njejtë në më shumë raste mund të jetë nën ndikimin e më shumë faktorëve të cilët janë jashtë kontrollit të mësimdhënësit (të diskutuara më poshtë në këtë analizë), dhe që këtej mësimdhënësit nuk duhet të notojnë në bazë të rezultateve të tilla të cilat nuk kanë ndikim.

Në kontekst me diskutimin për validitetin e notave eksterne, rezultatet e hulumtimit tregojnë se një pjesë e madhe e të anketuarve tek nxënësit dhe mësimdhënësit (77-90%) thonë se nota e mësimdhënësit më së miri paraqet njohuritë e marrura të nxënësve në krahim me notën e testimit ekstern. Poashtu, më shumë se gjysma e tyre thonë se pyetjet e testimit ekstern nuk janë të përshtatshme me materialin mësimor gjë e cila në të shumtën e rasteve është arsyeja e devijimit midis notës së testimit ekstern dhe notës së mësimdhënësit.


GRAFIKON 5




14| http://bro.gov.mk/docs/kriteriumi/Kriteriumi_za_ocenuvanje.pdf

15| <http://bro.gov.mk/?q=gimnazisko-obrazovanie-standardi>

GRAFIKON 6




- Përshtatje e shkëlqyer
- Shumë e mirë
- E mirë
- Material pjesërisht i përshtatshëm
- Përshtatje e pamjaftueshme
- Tjetër




- Përshtatje e shkëlqyer
- Shumë e mirë
- E mirë
- Material pjesërisht i përshtatshëm
- Përshtatje e pamjaftueshme
- Tjetër

Si do ta vlerësonit përshtatshmërinë e materialit mësimor, atë të cilin ua shpjegon mësuesi, me pyetjet e testimit ekstern? (në të majtë përgjigjet e nxënësve, në të djathtë përgjigjet e mësimitdhënësve)

GRAFIKON 7



- Lëshim i mësuesit që të notojë nxënësin në mënyrë objektive dhe reale
- Koha e kushtuar dhe gatitshmëria e nxënësit për të kaluar provimin
- Lëshim edhe i mësuesve edhe i nxënësve gjatë përgatitjeve për testim
- Papërshtatshmëria e pyetjeve të testimit ekstern me programin mësimor dhe materialet që janë mësuar
- Ndikimi i faktorëve të tjerë: _____
- Tjetër



- Lëshim i mësuesit që të notojë nxënësin në mënyrë objektive dhe reale
- Koha e kushtuar dhe gatitshmëria e nxënësit për të kaluar provimin
- Lëshim edhe i mësuesve edhe i nxënësve gjatë përgatitjeve për testim
- Papërshtatshmëria e pyetjeve të testimit ekstern me programin mësimor dhe materialet që janë mësuar
- Ndikimi i faktorëve të tjerë: _____
- Tjetër

Në qoftë se nota e marrur nga testimi ekstern, në një lëndë të caktuar, dallon nga nota që mësuesi ia ka lënë nxënësit gjatë vitit shkollor në po të njejtën lëndë, sipas mendimit tuaj, kjo është për shkak të: (në të majtë përgjigjet e nxënësve, në të djathtë përgjigjet e mësimitdhënësve)


Sidoqoftë, mbetet një mospërputhje e paqartë mes materialit mësimor dhe pyetjeve në testin ekstern duke e marrë parasysh faktin se BZHA-ja ka standarde për notim për të gjitha zonat dhe programet. Në realitet nota e testimit ekstern do duheshite ta tregon nivelin e diturisë dhe aftësisë në bazë të standardeve të zhvilluara, të cilat në fakt janë të njëjta me kriteriumet e mësimdhënësve gjatë formimit të notave (kriteriumet për notim apo vlerësim).

Diskutimi i mëparshëm tregon qartë zbatimin e kufizuar të rezultateve të vlerësimit ekstern, si dhe për nevojën e kombinimit të instrumenteve të ndryshme për të arritur qëllim e caktuar - objektivitet më të madh në vlerësim. Pjesë e hulumtimeve të OECD theksojnë rëndësinë e vëzhgimit të mësimdhënësve gjegjësisht mbledhjes së të dhënave në cilësinë e mësimdhënie, në fakt aftësitë e tyre për të planifikuar orët mësimore, të caktojnë qëllimet dhe të demonstrojnë që nxënësit i kanë arritur qëllimet e caktuara.

3. Realizimi i testimit ekstern


Rezultatet e testimit ekstern nuk janë indikator i përsosur i njohurive të nxënësve ose objektivitetit të mësimdhënësve. Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në vlerësimin e testimit ekstern të cilat në të njëjtën kohë zvogëlojnë besueshmërinë e notimit ekstern, në fakt kompromentojnë përdorimin e notës nga testimi ekstern si indikator për objektivitetin e mësuesit ose njohuritë e studentit. Ndikimi i këtyre faktorëve është theksuar gjatë procesit të zbatimit të notimit ekstern. Sipas rezultateve, 71% e të anketuarve tek mësimdhënësit ose 56% e nxënësve mendojnë se studentët kopjojnë gjatë zbatimit të testimit ekstern, ndërsa gati gjysma e të anketuarve mendojnë se mësuesit u ndihmojnë nxënësve gjatë zbatimit të testimit ekstern (40% e nxënësve dhe 47% e mësuesve). Më tej, pothuajse gjysma e të anketuarve (52% e mësuesve dhe 46% e nxënësve) besojnë se në të gjitha shkollat e mesme nuk sigurohen për afërsisht të barabarta për të kaluar testimin ekstern. Rezultatet e hulumtit janë të paraqitura në diagramet në vijim:

GRAFIKONI 8




A mendoni se nxënësit kopjojnë gjatë zbatimit të testimit ekstern? (në të majtë përgjigjet e nxënësve, në të djathtë përgjigjet e mësimdhënësve)

GRAFIKON 9



A mendoni se mësuesit u ndihmojnë apo u tregojnë nxënësve gjatë testimit ekstern? (në të majtë përgjigjet e nxënësve, në të djathtë përgjigjet e mësimitdhënësve)

GRAFIKON 10



A mendoni se ofrohen të njëjtat kushte, për marrjen e testit ekstern, në të gjitha shkollat e mesme? (në të majtë përgjigjet e nxënësve, në të djathtë përgjigjet e mësimitdhënësve)

Rezultatet e fituara nga ky hulumtim çojnë në përfundimin se rreth gjysma e nxënësve mendojnë se testimi ekstern është i ngarkuar me ndikim nga faktorë të cilët zvogëlojnë objektivitetin e notimit ekstern (për shembull, stresin që përjetojnë nxënësit dhe aftësinë e tyre për të përballuar sfidat në vetë ditën e testimit ekstern, kopjim, tregim, kushte të pabarabarta për kryerjen e testit). Heqja e këtyre faktorëve gjegjësisht zvogëlimi i ndikimit të tyre është vendimtare për testim të besueshëm në të ardhmen.


4. Sigurimi i informatave kthyesë nga testimi ekstern

Në kuadër të ciklit të politikave publike, ekziston domosdoshmëria për të siguruar informata kthyesë të cilat do të mundësojnë përmirësimin e cikleve të ardhshme nga ana e hartuesve dhe bartësve të politikave. Dinamizmi i tillë padyshim se do të kishte çuar në zhvillimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e politikës së testimit ekstern apo arsim cilësor. на екстерно оценување односно квалитетот во образованието.

Së pari, testimi ekstern duhet të sigurojë informacione në lidhje me objektivitetin e notimit nga ana e mësimeve. Sipas mendimit tonë, problematike është metoda për matjen e objektivitetit të notimit si një "koncesion" midis notës numerike duke monitoruar përparimin e nxënësit nga mësuesi, me notën numerike që vjen si rezultat nga testimi ekstern i njohurive të marrura të nxënësve. Me një fjalë, matja e devijimit e injoron komponentën e kontrollimit të brendshëm nga ana e mësimeve, por edhe lirinë e dhënë për mësuesin, në përputhje me standardet e vlerësimit të BZHA-së, të bëjë lëshim të mundshëm të notimit më së shumti deri në 0.75 të shkallës së notimit në fusha të ndryshme të programit. Për këtë arsye, do të ishte e patjetërsueshme të rishqyrtohet modeli i testimit ekstern në mënyrë që të sigurojë informacione më të mira për "përgjashtime" në mes të njohurive të parashikuara dhe njohurive të treguara tek nxënësit. Së dyti, rezultatet e testimit ekstern si qëllim primar kanë mësimeve gjegjësisht shërbejnë për mirënjohjen dhe/ ose dënimin e mësuesve. Në fakt, në bazë të kornizës ligjore që rregullon arsimin e mesëm, duke u bazuar në rezultatet e testimit ekstern të njohurive të nxënësve përcaktohet progresi i karrierës së stafit të mësimeve dhe bashkëpunëtorëve në shkolla, si dhe shumën e pagës së tyre (aplikimi i këtyre dy dispozitave disa herë po shtyhet). Gjithashtu, Ligji për arsim të mesëm, parashikon "ndihmë këshillues eksperte" për mësimeve nga ana e Biros për Zhvillimin e Arsimit.

Lidhja e fortë në mes të mirënjohjes dhe dënimin të mësimeve për rezultatet e arritura nga notimi ekstern ka ndikim të mundshëm në sjelljen e mësuesve gjegjësisht i inkurajon mësuesit që ligjëratat e tyre ti përshtasin me pyetjet e testimit ekstern ose të gjithë materialin ta përqëndrojnë atë që do të kontrollohet në testin ekstern (teaching to the test). Nga ana tjetër, tek studentët shfaqet mundësia e "të mësuarit / të mbajturit mend përgjigjet pyetjeve."

GRAFIKON 11



Mësimeveve paraparkishtë e konstaton notën përfundimtare, para afatit për kalimin e testimit ekstern, në një lëndë përkatëse?(në të majtë përgjigjet e nxënësve, në të djathtë përgjigjet e mësimeveve)


Për më tepër, sipas hulumtimit, gati 40% e të anketuarve në mesin e nxënësve mendojnë se mësuesit nuk e kanë të konstatuar notën përfundimtare para se të kalohet testi ekstern, gjë që krijon hapësirë për «rregullimin» e mëtejshëm të notave në varësi me notën e testit ekstern. Megjithatë, ky përfundim është konfirmuar vetëm nga 14% e të anketuarve në mesin e mësimeve. Në të njëjtën kohë, ky fakt hap dilema edhe në lidhje me funksionimin e sistemit të ditarit elektornik i cili padyshim që ndikon në perceptimet (dhe sjelljen) e mësuesve në lidhje me kopjimin, si dhe ndihma që u ofrohet nxënësve gjatë zbatimit të testimit ekstern (të diskutuar më parë).

Diskutimi i mësipërm sugjeron se përdorimi i notimit ekstern hap mundësinë për ndryshime të padëshiruara në sjelljen e mësuesve (si dhe të nxënësve) si pasojë e stimuljeve të cilat krijohen me anë të instrumentit të notimit ekstern (mirënjohje ose dënime për mësime-hënësit). Insistimi i tepruar për llogaridhënie nga mësuesit krijon nxitje negative gjegjësisht ndikon në cilësinë e mësimeve dhe në zbehjen e kreativitetit të mësuesve. Me këtë edhe më tej zvogëlohet cilësia e mësimeve, dhe në vend që të stimulohet notimi objektiv, cenohet vlefshmëria dhe vlerësimi i rregullt. Në fakt, pjesa më e madhe e të anketuarve (mësime-hënësit) theksojnë «humbjen e vazhdimësisë në mësime, kohën e humbur në fund të vitit shkollor, motivimin e dobët, ngarkesën, rritjen e stresit, presionin psikologjik, ndjenjën e nënstrimit të studentëve», si ndryshime që po ndodhin me vënien në funksion të testimit ekstern.

Për këtë arsye, është e nevojshme që të gjehet një ekuilibër në mes të kërkesës që mësime-hënësit të mbajnë përgjegjësi për notën e dhënë (shmangia e notimit ekstern) dhe nevojës për të përmirësuar objektivitetin e notimit. Aplikimi i vonuar i dispozitave ligjore është vetëm një situatë e përkohshme dhe nuk ofron mbrojtje të përhershme kundër ndryshimit të padëshiruar në sjelljen e mësuesve dhe nxënësve.

5. Përfshirja e palëve të interesuara, transparencë dhe komunikim me publikun në lidhje me politikën e testimit ekstern

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë së nxënësve dhe mësuesve (deri 80% -85% e të anketuarve), janë të pakënaqur me vënien në funksion të testimit ekstern, në fakt janë të mendimit se nuk duhet të vazhdohet me konceptin e testimit të ekstern (76% e mësuesve dhe 84% e nxënësve). Sipas mendimit tonë, rezultatet e tilla sugjerojnë nevojën ndërtimit të një konsensusi më të gjerë shoqëror dhe politik mes të gjithë palëve të interesuara gjegjësisht barazimi i interesave të ndryshëm me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri afatgjatë të politikës së testimit ekstern. Gjithashtu, duke pasur parasysh publicitetin e madh që kishte testimin ekstern në Republikën e Maqedonisë, është e patjetërueshme që rregullisht të komunikohet me publikun e gjerë, si dhe pjesëmarrja në debate me grupet e interesuara, me qëllim që publiku të jetë i informuar plotësisht dhe drejtë për të gjitha aspektet e politikës së testimit ekstern.



6. Efektiviteti i politikës së testimit ekstern – analiza e shpenzimeve

Hulumtimi në terren i cili u zhvillua tek mësimdhënësit dhe nxënësit kishte për qëllim mbledhjen e informatave mbi perceptimin e palëve të prekura direkt rreth kontributit që politika e notimit ekstern e jep për arritjen e qëllimit të caktuar- notim objektiv nga ana e mësimdhënësve. Me fjalë të tjera, të dhënat e mbledhura mund të shërbejnë si një tregues cilësor i efektivitetit të politikës së notimit ekstern (p.sh. shkalla e arritjes së qëllimit), mirëpo jo edhe efikasitetin e saj.

Vlerësimi i efektivitetit të politikës së testimit ekstern nënkuptoi përcaktimin e marrëdhënieve korekte në mes të burimeve të përdorura dhe kontributi i tyre në arritjen e qëllimit të caktuar. Çështja e efikasitetit është veçanërisht e rëndësishme në politikat publike për shkak të përdorimit të fondeve nga taksapaguesit, por edhe për shkak të nevojës për konsolidimin fiskal i cili është imponuar në vitet e fundit. Për më tepër, nevoja për përgjegjshmërinë e hartuesve të politikës së testimit ekstern (në aspektin e parave të shpenzuara dhe qëllimeve të arritura) është edhe më e madhe sepse pikërisht vet koncepti i testimit ekstern imponon dhe kërkon përgjegjshmëri në kuadër të arsimit.

Në vazhdim, efikasiteti i politikës së notimit ekstern shqyrtohet me metodën e analizës për shpenzime. Analiza përpiqet që të identifikojë të ashtuquajturat shpenzime marginale të testimit ekstern ose të shpenzimeve të tjera të shkaktuara si rezultat i vënies në funksion të testimit ekstern. Këto shpenzime nuk do të kishin ekzistuar nëse nuk implementoheshte testi ekstern. Megjithatë, një kufizim i madh në analizën e shpenzimeve vjen nga mungesa e të dhënave përkatëse për shpenzimet e shkaktuara, e cila është rezultat i ngurimit institucioneve për të ndarë të dhënat dhe mungesa e plotë e transparencës buxhetore dhe llogaridhënies për mjetet e shpenzuara. Analiza përpiqet të bën përafrimin e shpenzimeve duke u bazuar në të dhënat e publikuara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për periudhën 2011-2016 (Tabela 1), si dhe shumën e përgjithshme të pagave bruto të paguara për të punësuarit në administratën publike të cilët një pjesë të kohës së tyre e shpenzojnë në testimin ekstern (për shembull, planifikimi, koordinimi, implementimi, monitorimi, vlerësimi) Tabela 2.


Në Tabelën 1, jipet një përmbledhje e shpenzimeve buxhetore të përfshira në kuadër të dy nën-programeve: Përgatitja e testeve për kontrollimin ekstern të nxënësve (programi i buxhetit - Zhvillimi dhe përgatitja e programit mësimor) dhe Testimi ekstern për arritjet e nxënësve (programi i buxhetit - Përgatitja dhe realizimi i provimit shtetëror).

Në kuadër të këtyre dy programeve janë të mbuluara të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me planifikimin, organizimin, zbatimin dhe kontrollin e testimit ekstern, të tilla si: pagesat dhe honoraret për angazhimin e personave nga jashtë në procesin e testimit të ekstern (përgatitja e testeve, përkthimi, lexuesit e pavarur, kontrollorët. etj.), mirëmbajtjen e sistemit elektronik për testimin ekstern dhe kështu me radhë. Shuma e këtyre shpenzimeve mund të jetë edhe më e lartë varësisht nga ajo se a ekzistojnë shpenzime «të fshehura» të cilat janë pjesë e testimit ekstern, mirpo prap se prap janë të përfshira në kuadër të programeve tjera (p.sh., blerjen e softuerit për testimin elektronik, trajnimet, shpenzimet për transport, etj).



Tabela 1: Buxheti (nën) programet në fushën e testimit ekstern¹⁶

Buxheti i RM (nënprogramet)	2016	2015	2014	2013	2012	2011	Gjithsej në denarë
Përgatitja e testeve për kontrollimin ekstern të nxënësve	1 150 000	1 780 000	/	/	/	/	2 930 000
Vlerësimi ekstern i të arriturave të nxënësve	14 830 000	5 903 000	8 393 000	13 489 000	2 913 000	10 067 000	55 595 000
Planifikuar	58 525 000						
Realizuar (vlerësim 90%)	52 672 500						



Megjithatë, këtu duhet bërë dallimi në mes të planifikimit buxhetor dhe shpenzimeve reale apo deri në çfarë mase janë shpenzuar mjetet e planifikuara gjatë vitit. Për shembull, llogaritë përfundimtare të buxhetit për vitin 2014 dhe 2015 tregojnë këto dy vite përqindja e realizimit të këtyre dy nënprogrameve buxhetore ishte 96.5%, dmth kjo pjesë e mjeteve është shpenzuar. Pasi që llogaritë përfundimtare për vitin 2011, 2012 dhe 2013 nuk përmbajnë të dhëna të sakta për realizimin e programeve buxhetore, kjo analizë supozon se përqindja e shpenzimeve reale është 90%.

Në Tabelën 2 është llogaritur përafërsisht shuma e shpenzimeve të pagave të punonjësve të cilët plotësisht ose pjesërisht e kushtojnë kohën e tyre në çështje lidhur me testimin ekstern. Llogaritjet bazohen në të dhënat e siguruar nga Qendra Shtetërore e Provimeve dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), paga mesatare mujore bruto e një të punësuarit i cili punon në testimin ekstern me orar të plotë është 35 000 denarë (paga mesatare mujore bruto në BZHA për periudhën 2011-2016).


Përderisa Qendra Shtetërore e Provimeve paraqitën të dhënat mbi numrin e punonjësve të cilët punojnë në testimin ekstern me orar të plotë, BZHA ka paraqitur numrin e përgjithshëm të të punësuarve në institucion duke u arsyetuar se këshilltarët punojnë në testimin ekstern ndërsa punonjësit tjerë janë të përfshirë në segmente të caktuara që lidhen me testimin ekstern (në të njejtën kohë të gjithë të punësuarit janë të angazhuar edhe në detyra tjera në kuadër të kompetencave të BZHA-s. Prandaj, sasia e përafërt e pagave bruto në BZHA bëhet me supozimin se çdo punonjës në këtë institucion, $\frac{1}{4}$ (një të katërtën) e kohës së punës ia përkushton testimit ekstern (dmth 10 orë në javë). Nga institucionet tjera nuk u arrit të sigurohen të dhëna.

16| Буџет на Република Македонија 2011-2016 (<http://finance.gov.mk/mk/node/575>)

Tabela 2: Pagat bruto të punonjësve në fushën e testimit ekstern

INSTITUCIONET	Shuma e pagave bruto të punonjësve të cilët punojnë në testimin ekstern në vite të caktura							
	2016	2015	2014	2013	2012	2011	Gjithsej	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	/	
Byroja për Zhvillimin e Arsimit	15 645 000	15 540 000	13 545 000	13 020 000	12 390 000	12 705 000	82 845 000	
Qendra shtetërore e provimeve	1 260 000	840 000	840 000	840 000	840 000	420 000	5 040 000	
Qendra për arsim profesional dhe trajnim	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	/	
Inspektorati Shtetëror i Arsimit	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	/	
GJITHSE NË DENARË	87 885 000							

Sipas analizës së shpenzimeve, kostoja totale e testimit ekstern për periudhën 2011-2016 arrin në 140,557,500 denarë. Dy supozimet e rëndësishme mbi të cilat bazohet analiza i përkasin nivelit të shpenzimeve të mjeteve buxhetore për testimin ekstern, apo numrin e të punësuarve dhe të orarit të punës në administratën publike dedikuar testimit ekstern. Këtu, theksojmë se në analizë mungon vlerësimi i shpenzimeve për punonjës nga disa institucione të cilat kanë ompetenca në fushën e testimit ekstern. Po ashtu, ky rishikim nuk mbulon shpenzimet eventuale të cilat janë bërë në vitet buxhetore para 2011. Për këtë arsye, është mjaft e sigurt se shpenzimet aktuale lidhur me testimin ekstern do të mund të ishin më të larta se sa janë treguar në kuadër të analizës.



Në çdo rast, shpenzimet e përcaktuara në kuadër të analizës paraqesin shpenzime shtesë të cilat duhet ekskluzivisht të shikohen nga prizmi i qëllimit të pëcaktuar: objektiviteti në notim. Përshtypja është se nuk ka prova bindëse se a është arritur qëllimi i testimit ekstern gjë e cila u konfirmua nga anketat e realizuara me mësimdhënësit dhe nxënësit. Nga ana tjetër, «kursimi» nga këto shpenzimeve do të nënkuptonte kthim në gjendjen status quo ex ante dhe përsëri përballje me problemin që nga fillimi. Kështu që, përmirësimi i efikasitetit të testimit ekstern është i mundshëm, vetëm duke pëcaktuar një reth më të gjerë të masave dhe instrumenteve që do të vlerësojnë objektivitetin e mësimdhënësve dhe do të kontribuojnë në arsimin cilësor. Lidhja e mirë mes masave dhe objektivave të politikës do të sigurojë menaxhim më të mirë me shpenzimet.


VI. PËRFUNDIMET E PËRGJITHSHME PËRMBLEDHËSE DHE REKOMANDIMET E HULUMTIMIT

1. Qëllimi i politikës së vlerësimit të ekstern ka ndikim të kufizuar në qëllimin përfundimtar - arsim cilësor

Testimi ekstern vetëm pjesërisht kontribuon në arritjen e qëllimit përfundimtar- përmirësimin e kualitetit arsimor. Përmirësimi i objektivitetit në notim nga ana e mësimdhënësive është vetëm një nga më shumë faktorë të cilët kontribuojnë në arsim më cilësor. Cilësia në arsim patjetër të llogaritet dhe në tërësi gjegjësisht duhet të ketë qasje gjithpërfshirëse dhe jot të pjesërishtme¹⁷. Injorimi i faktorëve të tjerë të arsimit cilësor dëmton efikasitetin dhe efektivitetin e politikës së notimit ekstern. Si rezultat i kësaj i propozojmë pikat në vazhdim:

a. Ridefinimi i plotë i politikës së testimit ekstern dhe përdorimit i këtij instrumenti në drejtim të avancimit të procesit arsimor dhe kontributi ndaj përmirësimit të kualitetit arsimor në të cilën do të jenë të integruara më shumë instrumente me të cilat do të ndikohet mbi të gjithë faktorët në arsimi (inpute, procese dhe rezultate). Heqja e të gjitha dispozitave të ligjit në

17| Национална програма за развој на образованието во Република Македонија 2005-2015



pjesën ku rregullohen dispozitat e sanksioneve për mësimdhënësit si dhe ndërhyrje ligjore adekuata në pjesën ku rregullohet mundësia për tu dhënë 1 (njish) në dëftesat e nxënësve si notë e arritur në testimin ekstern. Kjo dispozitë është në kundërshtim me ligjin për arsim fillor dhe të mesëm dhe e dëmton procesin arsimor dhe vetë nxënësit në fazat e arsimit të tyre të mëtutjeshëm dhe duhet të hiqet.


b. Krijimi i atmosferës së një gare të shëndoshë midis shkollave për kontrollim apo vërtetim të njohurive të nxënësve dhe objektiviteti i mësimdhënësve pa kurfarë dënimi, për cilën do qoftë pjesë të procesit. Mbajtja e instrumentit të testimit ekstern për realizim të testeve periodike eksterne, në një mostër reprezentative, sipas zgjedhjes së lirë në bazë vullnetare, rezultatet e të cilave do të përdoren për të vlerësuar të gjithë faktorët që kontribuojnë në kualitetin arsimor.

2. Zgjedhja e masave dhe instrumenteve është e papërshtatëshme për arritjen e qëllimit të vlerësimit ekstern.

Testimi ekstern nuk është i mjaftueshëm që të arrihet qëllimi i dëshiruar – notim objektiv dhe real nga ana e mësimdhënësve gjegjësisht ekziston papërshtatshmëri në mes testimit ekstern dhe qëllimit të caktuar. Rezultatet e testimit ekstern kanë vlefshmëri të ulët dhe e injorojnë vlerësimin formativ nga ana mësimdhënësve (dmth notimi në bazë të ndjekjes së nxënësit gjatë gjithë vitit).


Në këtë drejtim rekomandohen pikat në vijim:

- a. Kombinim i testimit ekstern me modelet komplementare të vlerësimit të mbrendshëm si shembull, vlerësimi kolegial nga ana e mësimdhënësve, vëzhgim i mësimdhënësve dhe një pako masash dhe instrumentesh me të cilat do të mund të sigurohet barazpeshë më e mirë në mes vlefshmërisë dhe objektivitetit në notim.
- b. Përforcimi i kriterëve dhe zbatimi i standardeve të larta për punësim të mësimdhënësve në shkollat e mesme, si dhe trajnime të posaçme dhe ndjekja e mësimdhënësve të rinjë si masë ndaluese të cilat kontribuojnë për të arritur qëllimin – arsim kualitativ.
- c. Organizimi i trajnimeve të rregullta për mësimdhënësit duke zhvilluar praktika më të mira dhe mjete inovative për notim objektiv.



3. Testimi ekstern është i ekspozuar ndaj ndikimit të faktorëve të “jashtëm” të cilët e dëmtojnë kredibilitetin e vetë procesit si dhe e ulin besueshmërinë rezultateve

Përvoja e deritanishme tregon një numër të madh të defekteve të cilat rishfaqen me hyrjen në funksion të testimit ekstern, si për shembull, pengesa teknike (problem me softuerin apo lidhjen), kushte jot të barabarta në shkolla, si dhe monitorim jo adekuat i nxënësve më çka tolerohet dhe ju mundësohet kopjim ose ndihmë gjatë testimit nga ana e mësimit-hënësve. Si rrjedhojë, propozohet:



a. Duke i ndjekur rekomandimet për ridefinimin e qëllimeve dhe mënyrave të testimit ekstern si dhe zbatimin e kontrollimit të rastësishëm dhe vullnetar të njohurive është i nevojshëm revizion i plotë i konceptit dhe metodave të testimit, në të cilin pyetjet dhe rezultatet nuk do të jenë të publikuara paraprakisht.

b. I paevitueshëm është krijimi i kushteve më të mira teknike për zbatimin e vlerësimit ekstern.

c. Përforcim i monitorimit gjatë zbatimit të testimit ekstern me qëllim që të zvogëlohet praktika e kalimit të testit në mënyrë të pandershme si dhe të rritet objektiviteti i rezultateve të testimit ekstern në mënyrë që të përmirësohet kualitetit në arsim.


4. Lidhja e fortë mes rezultateve të vlerësimit eksterndhe mundësia e mirënjohjes/dënimit i inkurajon mësuesimdhënësit ta përshtasin sjelljen dhe mësimin e tyre në bazë të nevojave të testimit ekstern

Këmbëngulja e fortë për përgjegjësi tek mësimitdhënësit, nëpërmjet marrjes së mirënjohjes apo dënimit në varshmëri me rezultatet e testimit ekstern, do të mund të zvogëlojë kualitetin e ligjeratave si dhe validitetin e notimit. Që këtu, është e domosdoshme të arrihet një barazpeshë në mes të rezultateve të testimit ekstern dhe kërkimit të përgjegjësive së mësimitdhënësit për rezultatet e arritura. Në atë drejtim rekomandohen pikat në vijim:

a. Shkëputja e lidhjes në mes rezultateve të testimit ekstern dhe mirënjohjes gjegjësisht dënimit të mësimitdhënëse;

b. Formimi i një grupi të gjerë të indikatorëve në bazë të së cilëve përcaktohen mundësitë për konkurrencë në mënyrë që të përmirësohet kualiteti arsimor.

5. Komunikimi joadekuat me publikun më të gjerë dhe publiciteti negativ i politikës së testimit ekstern vë në pikëpyetje tërë modelin e testimit ekstern dhe mundësitë përeformën e saj



Tema e testimit ekstern në Republikën e Maqedonisë ka shkaktuar interesim të madh dhe ka ngritur shumë pyetje dhe debate mes të gjithë palëve të interesuara në shoqëri: nxënës, prindër, mësues, organe qeveritare, organizata jo qeveritare, parti politike dhe kështu me radhë. Zakonisht, në periudhën para zbatimit të testit, ekziston interes shumë i madh i mediave, si në mediat tradicionale ashtu edhe në rrjetet sociale.

Përshtypja është se një pjesë e madhe e palëve të interesuara kanë vërejtje në lidhje me modelin që po implementohet tani. Besojmë se mungesa e konsensusit të gjerë në lidhje me politikën e testimit ekstern përbën një kërcënim serioz për efektshmërinë afatgjatë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e politikës. Prandaj, propozojmë pikat në vazhdim:

- a. **Ndërtimi i një konsensusi më të gjerë social - politik mes të gjitha palëve të interesuara përmes përfshirjes së tyre aktive në krijimin dhe zbatimin e politikës së vlerësimit ekstern.**
- b. **Komunikim i rregullt dhe adekuat me publikun e gjerë, si dhe pjesëmarrja në debate me palët e interesuara, me qëllim që publiku të jetë i informuar drejtë dhe në tërësi për të gjitha aspektet e politikës së testimit ekstern.**

6. Efikasiteti i politikës së të kontrollimit esktern i të arriturave të nxënësve

Përmirësimi i efikasitetit të vlerësimit ekstern si lidhje ndërmjet inpleteve dhe objektivave të arritura rrjedh jo vetëm nga nevoja për qeverisje të mirë dhe llogaridhënie ndaj autoriteteve publike për qytetarët, por edhe më tepër nga rëndësia e kësaj reforme për brezat e ardhshëm dhe zhvillimi socio-ekonomik i vendit. Ky hulumtim tregon se nuk ka prova bindëse se objektivat e testimit ekstern janë arritur pavarësisht fondeve të investuara të buxhetit në vitet e fundit.

Rekomandimet e propozuara më parë për ridizajnimin e politikës ekstern, qëllimet dhe mënyrat e testimit ekstern, si dhe kombinimi i tyre me modele plotësuese të vlerësimit të brendshëm padyshim se do të përmirësojnë efikasitetin e kësaj politike. Si shtesë propozojmë:

- a. **Përmirësimi i transparencën buxhetore dhe informimi më i mirë i publikut mbi shpenzimet e bëra dhe «çmimi i shpenzimeve» të testimit ekstern në Maqedoni.**



VII. BIBLIOGRAFIJA

- Cook and Campbell (1979), Quasi-Experimentation
- Education in Slovenia, European Commission, 2013. http://ec.europa.eu/europeaid/education-slovenia_en
- Finland: Slow and Steady Reform for Consistently High Results, OECD, 2010.
- Literacy Skills For The World Of Tomorrow – Further Results From Pisa 2000 Executive Summary, Unesco Institute For Statistics , Organisation For Economic Co-Operation And Development, <http://www.oecd.org/edu/school/2960581.pdf>
- Programme for international student assessment and non-OECD countries, OECD, UNESCO 2003 2 TIMSS 2011 International results in mathematics, Trends in international mathematics and science studies 3 Progress in International Reading Literacy Study, 2001, <https://www.oecd.org/pisa/pisaproducts/46581035.pdf>
- Woessmann Ludger, Why Students in Some Countries Do Better? - International evidence on the importance of education policy, <http://educationnext.org/whystudentsinsomecountriesdobetter/>
- EVALUATION AND ASSESSMENT FRAMEWORKS FOR IMPROVING SCHOOL OUTCOMES (OECD), <http://www.oecd.org/edu/school/46927511.pdf>
- USING STUDENT TEST RESULTS FOR ACCOUNTABILITY AND IMPROVEMENT: A LITERATURE REVIEW (OECD, Education Working Paper, No. 54)
- Steele J. L., Hamilton L. S., Stecher B. M (2010): Incorporating Student Performance Measures into Teachers Evaluation Systems
- Водич за екстерно тестирање (<http://mon.gov.mk/images/documents/eksterno/Ekterno-Vodich-Vest.pdf>)
- Закон за основното образование консолидиран текст („Службен весник на Република Македонија“ бр. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 и 30/2016)
- Закон за средното образование, консолидиран текст („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 и 30/2016)
- Листа на наставни предмети од средно образование со развиени стандарди за оценување <http://bro.gov.mk/?q=gimnazisko-obrazovanie-standardi>
- Национална програма за развој на образованието во РМ 2005-2015, <http://goo.gl/h1ck3R>
- Буџет на Република Македонија 2011-2016 (<http://finance.gov.mk/mk/node/575>)
- <http://bro.gov.mk/?q=gimnazisko-obrazovanie-standardi>
- http://bro.gov.mk/docs/kriteriumi/Kriteriumi_za_ocenuvanje.pdf
- http://bro.gov.mk/docs/zakonodavstvo/sredno/Odluka_na_Ustaven_sud_Zakon_za_Sredno_obrazovanie_01072009.pdf
- <http://edemokratija.mk/documents/10157/29517/%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0+%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B3%D1%80%D0%B0%D0%BC%D0%B0+%D0%B7%D0%B0+%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B2%D0%BE%D0%B8+%D0%BD%D0%B0+%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B5%D1%82%D0%BE+%D0%B2%D0%BE+%D0%A0.%D0%9C.+2005-2015.pdf>
- <https://www.oecd.org/pisa/pisaproducts/46581035.pdf>
- <http://respublica.edu.mk/blog/2016-03-11-10-34-46>

ANEKSI 1_MËSIMDHËNËS

ANKETË PËR MATJEN E KONTRIBUTIT TË TESTIMIT EKSTERN NË OBJEKTIVITETIN E NOTIMIT DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT

Numri i pyetësorit: _____

Ky pyetësor është pjesë përbërëse e projektit «Pjesëmarrje më e madhe, dhe Instituti dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (CUP).

Qëllimi i këtij pyetësori është që të mirren të dhëna statistikore të vlefshme në mendimin e mësuesve dhe nxënësve, në lidhje me kontributin e testimit ekstern në objektivitetin e notimit dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Rezultatet e këtij hulumtimi do të jenë bazë për eks post analizë mbi politikën e testimit ekstern.

Pyetësori është anonim

I. TË DHËNA DEMOGRAFIKE PËR TË ANKETUARIN

1. Gjinia

- a. Mashkull
- b. Femër

2. Përkatësia etnike

- a. Maqedonase
- b. Shqiptare
- c. Turke
- d. Rome
- e. Sërbe
- f. Vllahe
- g. Boshnjake
- h. Tjetër _____

3. Shkolla dhe komuna: _____

4. Moshë

- a. Deri 25 vjet
- b. 26-33
- c. 34-41
- d. 42-49
- e. 50+

5. Statusi i të anketuarit

- a. Mësues i lëndës _____

II. PYETJE PËR NDIKIMIN E TESTIMIT EKSTERN NË OBJEKTIVITETIN E NOTIMIT

6. A mendoni se me testimin ekstern është duke u përmirësuar objektiviteti i mësuesve në notimin e nxënësve?

- a. Po
- b. Pjesërisht po përmirësohet
- c. Nuk ka asnjë ndikim

7. Në qoftë se nota e marrur nga testimi ekstern, në një lëndë të caktuar, dallon nga nota që mësuesi ia ka lënë nxënësit gjatë vitit shkollor në po të njejtën lëndë, sipas mendimit tuaj, kjo është për shkak të:

- a. Lëshim i mësuesit që të notojë nxënësin në mënyrë objektive dhe reale
- b. Koha e kushtuar dhe gatitshmëria e nxënësit për të kaluar provimin
- c. Lëshim edhe i mësuesve edhe i nxënësve gjatë përgatitjeve për testim
- d. Papërshtatshmëria e pyetjeve të testimit ektern me programin mësimor dhe materialet që janë mësuar
- e. Ndikimi i faktorëve të tjerë: _____

8. Mësimdhënësi paraparkisht e konstaton notën përfundimtare, para afatit për kalimin e testimit ekstern, në një lëndë përkatëse

- a. Po
- b. Jo

9. Cila notë pasqyron më së miri njohuritë e marrura në një lëndë të caktuar?

- a. Notimi i mësuesit
- b. Notimi nga testimi ekstern
- c. Të dy notat
- d. Asnjëra nga notat
- e. Nuk e di

10. A mendoni se nxënësit kopjojnë gjatë zbatimit të testimit ekstern?

- a. Po, në të shumtën e rasteve
- b. Po, në disa raste
- c. Vetëm në disa raste
- d. Jo
- e. Nuk e di

11. A mendoni se mësuesit u ndihmojnë apo u tregojnë nxënësve gjatë testimit ekstern?

- a. Po, në të shumtën e rasteve
- b. Po, në disa raste
- c. Vetëm në disa raste
- d. Jo
- e. Nuk e di

12. A mendoni se ofrohen të njëjtat kushte, për marrjen e testit ekstern, në të gjitha shkollat e mesme?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

13. Si do ta vlerësonit përshtatshmërinë e materialit mësimor, atë të cilin ua shpjegon mësuesi, me pyetjet e testimit ekstern?

- a. Përshtatje e shkëlqyer
- b. Shumë e mirë
- c. Material pjesërisht i përshtatshëm
- d. Përshtatje e pamjaftueshme

14. Cilat janë sugjerimet tuaja për përmirësimin e objektivitetit gjatë notimit nga ana e mësuesit?

III. PYETJEPËRNDIKIMIN E TESTIMIT EKSTERN NË PËRMIRËSIMIN E CILËSISË NË ARSIM

15. Si do ta vlerësoni ndikimin e testimit ekstern drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit?

- a. Nuk ka ndikim
- b. Ka pak ndikim
- c. Ka ndikim të caktuar
- d. Ka ndikim të rëndësishëm

16. Si do ta vlerësoni ndikimin e testimit ekstern në procesin e mësimit dhe marrjen e njohurive tek nxënësit?

- a. Nuk ka ndikim
- b. Ka pak ndikim
- c. Ka ndikim të caktuar
- d. Ka ndikim të rëndësishëm

17. Vlerësoni kushtet e mësimit në shkollën tuaj?

- a. Të shkëlqyeshme
- b. Të mira
- c. Pjesërisht të mira
- d. Jo të mjaftushme

18. Me implementimin e testimit ekstern, cilat janë pjesët në të cilat mendoni se ka PËRMIRËSIM?

- a. Notim më objektiv
- b. Njohuri të përmirësuara
- c. Motivim i nxënësve për mësim
- d. Atmosferë e përmirësuar e të mësuarit
- e. Konkurrencë në mësim
- f. Kualitet në arsim
- g. Përgatitje e përmirësuar – motivimi i mësimitdhënësve
- h. Rezultate të përmirësuara tek nxënësit
- i. Tjetër _____
- j. Nuk ka asnjë ndryshim

19. Me implementimin e testimit ekstern, cilat janë tre fushat në të cilat ka NGECJE?

- a. _____
- b. _____
- c. _____

20. Sa jeni të kënaqur me implementimin e politikës për testimin ekstern?

- a. I/e kënaqur
- b. Pjesërisht i/e kënaqur

- c. Nuk jam i/e kënaqur
- d. Nuk kam koment

21. A e konsideroni të nevojshme që të vazhdohet me testimin ekstern?

- a. Po
- b. Po, por me disa modifikime
- c. Jo
- d. Nuk e di

22. Nëse përgjigja është PO ose JO shpjegoni arsyet pse?

23. Cilat janë propozimet tuaja për përmirësimin e kualitetit në arsim?

24. Çfarë duhet të jetë prioritet për institucionet kompetente (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, Qendra për Zhvillim të Arsimit dhe Qendra Shtetërore për provime) në 12 muajt e ardhshëm në fushën e arsimit, me qëllim që të përmirësohet cilësia e arsimit?

25. A i ndiqni analizat ose raportet të përgatitura nga ana e organeve kompetente (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, Qendra për Zhvillim të Arsimit dhe Qendra Shtetërore për provime), për suksesin në testimin ekstern?

26. Nëse përgjigja është PO, sa janë valide dokumentet e përmendura?

JU FALEMINDERIT!

ANEKSI 2_NXËNËS

ANKETË PËR MATJEN E KONTRIBUTIT TË TESTIMIT EKSTERN NË OBJEKTIVITETIN E NOTIMIT DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT

Numri i pyetësorit: _____

Ky pyetësor është pjesë përbërëse e projektit «Pjesëmarrje më e madhe, dhe Instituti dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (CUP).

Qëllimi i këtij pyetësori është që të mirren të dhëna statistikore të vlefshme në mendimin e mësuesve dhe nxënësve, në lidhje me kontributin e testimit ekstern në objektivitetin e notimit dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Rezultatet e këtij hulumtimi do të jenë bazë për eks post analizë mbi politikën e testimit ekstern.

Pyetësori është anonim

I. TË DHËNA DEMOGRAFIKE PËR TË ANKETUARIN

1. Gjinia

- a. Mashkull
- b. Femër

2. Përkatësia etnike

- a. Maqedonase
- b. Shqiptare
- c. Turke
- d. Rome
- e. Sërbe
- f. Vllahe
- g. Boshnjake
- h. Tjetër _____

3. Shkolla dhe komuna: _____

4, Moshë

- a. Viti i parë
- b. Viti i dytë
- c. Viti i tretë
- d. Viti i katërt

II. PYETJE PËR NDIKIMIN E TESTIMIT EKSTERN NË OBJEKTIVITETIN E NOTIMIT

5. A i vlerësojnë mësimdhënësit nxënësit në bazë të njohurive të treguara gjatë orëve të mësimi?

- a. Po
- b. Po, në të shumtën e rasteve
- c. Pjesërisht
- d. Jo, në të shumtën e rasteve
- e. Aspak

6. A mendoni se me testimin ekstern është duke u përmirësuar objektiviteti i mësuesve në notimin e nxënësve?

- a. Po
- b. Pjesërisht po përmirësohet
- c. Nuk ka asnjë ndikim

7. Në qoftë se nota e marrur nga testimi ekstern, në një lëndë të caktuar, dallon nga nota që mësuesi ia ka lënë nxënësit gjatë vitit shkollor në po të njejtën lëndë, sipas mendimit tuaj, kjo është për shkak të:

- a. Lëshim i mësuesit që të notojë nxënësin në mënyrë objektive dhe reale
- b. Koha e kushtuar dhe gatitshmëria e nxënësit për të kaluar provimin
- c. Lëshim edhe i mësuesve edhe i nxënësve gjatë përgatitjeve për testim
- d. Papërshtatshmëria e pyetjeve të testimit ektern me programin mësimor dhe materialet që janë mësuar
- e. Ndikimi i faktorëve të tjerë: _____

8. Mësimdhënësi paraparkisht e konstaton notën përfundimtare, para afatit për kalimin e testimit ekstern, në një lëndë përkatëse?

- a. Po
- b. Jo

9. Cila notë pasqyron më së miri njohuritë e marrura në një lëndë të caktuar?

- a. Notimi i mësuesit
- b. Notimi nga testimi ekstern
- c. Të dy notat
- d. Asnjëra nga notat
- e. Nuk e di

10. A mendoni se nxënësit kopjojnë gjatë zbatimit të testimit ekstern?

- a. Po, në të shumtën e rasteve
- b. Po, në disa raste
- c. Vetëm në disa raste
- d. Jo
- e. Nuk e di

11. A mendoni se mësuesit u ndihmojnë apo u tregojnë nxënësve gjatë testimit ekstern?

- a. Po, në të shumtën e rasteve
- b. Po, në disa raste
- c. Vetëm në disa raste
- d. Jo
- e. Nuk e di

12. A mendoni se ofrohen të njëjtat kushte, për marrjen e testit ekstern, në të gjitha shkollat e mesme?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

13. Vlerësojeni ambientin e mësimit në shkollën tuaj?

- a. Ambient i përsosur

- b. Ambient shumë i mirë
- c. Ambient i mirë
- d. Pjesërisht i përshtatshëm
- e. I pakënaqshëm

14. Si do ta vlerësonit përshtatshmërinë e materialit mësimor, atë të cilin ua shpjegon mësuesi, me pyetjet e testimit ekstern?

- a. Përshtatje e shkëlqyer
- b. Shumë e mirë
- c. Material pjesërisht i përshtatshëm
- d. Përshtatje e pamjaftueshme

15. Sa jeni të kënaqur me implementimin e politikës për testimin ekstern?

- a. I/e kënaqur
- b. Pjesërisht i/e kënaqur
- c. Nuk jam i/e kënaqur
- d. Nuk kam koment

16. A e konsideroni të nevojshme që të vazhdohet me testimin ekstern?

- a. Po
- b. Po, por me disa modifikime
- c. Jo
- d. Nuk e di

17. Nëse përgjigja është PO ose JO shpjegoni arsyet?

JU FALEMINDERIT!



Projekti: Pjesëmarrje më e madhe, politika
dhe rregullativë më e mirë

Testimi ekstern, notimi, sfidat, dhe hapat e ardhshëm: Testim ekstern me çdo kusht?



Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (CUP)

Rr. Rajko Zhinsifov nr.44/1,
1000 Shkup – Republika e Maqedonisë

Ueb: www.cup.org.mk

Tel: +389(0)2 6092-216

Faks: +389(0)2 6092-216

E-mail: info@cup.org.mk

Instituti ZIP

Bul. "Partizanski Odredi" 106/1-3
1000 Shkup – Republika e Maqedonisë

Ueb: www.zipinstitute.mk

Tel: +389 (0)2 615 98 32

Mob: +389 (0)70 222 811

E-mail: info@zipinstitute.mk